<p>dorëzimin e informacionit dhe dokumenteve sipas kërkesës së Byrosë.</p> <p>8. Gjykata merr aktvendim për dorëzimin e dokumentit dhe informacionit nëse vlerëson se kërkesa e Byrosë është e bazuar dhe arsyetuar.</p> <p>9. Personi nga paragrafi 7 i këtij neni, obligohet ta zbatojë aktvendimin e marrë nga gjykata sipas paragrafit 8 të këtij neni, jo më larg se pesë (5) ditë nga pranimi i aktvendimit. Në rast të mos zbatimit të aktvendimit të gjykatës nga personit ndaj të cilit është marrë aktvendimi, Byroja paraqet kallëzim penal te Prokurori i Shtetit për veprën penale të mos ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.</p> <p>10. Informacioni i klasifikuar sigurohet në përputhje me ligjin përkatës për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë.</p> <p>11. Të dhënat personale do të trajtohen dhe përpunohen në përputhje me ligjin përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale.</p>	<p>and documents at the request of the Bureau.</p> <p>8. The court renders a ruling for submission of the document and information if it assesses that the request of the Bureau is grounded and justified.</p> <p>9. The person from paragraph 7 of this Article is obligated to comply with the Court ruling according to paragraph 8 of the present Article, not later than five (5) days from the receipt of the ruling. In case of non-compliance with the court ruling by the person against whom it was rendered, the Bureau submits a criminal report to the State Prosecutor for the criminal offense of non-execution of court decisions.</p> <p>10. Classified information shall be ensured in accordance with the relevant law on classification of information and security clearance.</p> <p>11. Personal data shall be treated and processed in accordance with the relevant law on protection of personal data.</p>	<p>8. Sud donosi rešenje o dostavi dokumenata i informacija ako oceni da je zahtev Biroa osnovan i opravdan.</p> <p>9. Lice iz stava 7. ovog člana je dužno da izvrši sudsko rešenje iz stava 8. ovog člana najkasnije u roku od pet (5) dana od prijema rešenja. U slučaju da lice, protiv kojeg je rešenje doneto, ne izvrši sudsko rešenje, Biro podnosi krivičnu prijavu državnom tužiocu za krivično delo neizvršavanje sudskih odluka.</p> <p>10. Poverljive informacije se pružaju u skladu sa relevantnim zakonom o klasifikaciji informacija i verifikaciji bezbednosti.</p> <p>11. Lični podaci tretiraće se i obrađivati u skladu sa relevantnim zakonom o zaštiti ličnih podataka.</p>
--	---	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 22</b> <b>E drejta për përfaqësues</b></p> <p>1. Pala në procedurë ka të drejtë të angazhojë përfaqësues të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi, gjatë procedurës së verifikimit në Byro dhe gjatë procedurës së konfiskimit në Gjykatë.</p> <p>2. Pala në procedurë ka të drejtë në ndihmë juridike falas sipas legjislacionit në fuqi.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 22</b> <b>The right to a representative</b></p> <p>1. The party to the procedure has the right to engage authorized representatives according to the legislation in force, during the verification procedure at the Bureau and during the confiscation procedure at the Court.</p> <p>2. The party to the procedure has the right to free legal aid according to the legislation in force.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 22</b> <b>Pravo na zastupanje</b></p> <p>1. U toku postupka provere u Birou i postupka oduzimanja pred sudom, stranka u postupku ima pravo da angažuje ovlašćenog zastupnika u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p> <p>2. Stranka u postupku ima pravo na besplatnu pravnu pomoć u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 23</b> <b>Periudha e verifikimit të pasurisë</b></p> <p>1. Verifikimi i pasurisë bëhet për pasurinë e fituar gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit publik nga ana e personit zyrtar.</p> <p>2. Përgjashtimisht, kur Byroja vlerëson apo konstaton se pasuria e personit zyrtar e fituar pas periudhës së ushtrimit të funksionit publik është në masë të madhe më e lartë se të hyrat e ligjshme apo pasuria e fituar gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit publik nga ana e personi zyrtar, Byroja mund të zgjerojë verifikimin për një periudhë jo më</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 23</b> <b>Asset verification period</b></p> <p>1. Verification of assets is done for the assets acquired during the period of exercising the public function by the official.</p> <p>2. Exceptionally, when the Bureau assesses or finds that the assets of the official person acquired after the period of exercising the public function are to a large extent higher than the legal income or the assets acquired during the period of the exercise of the public function by the official person, the Bureau may extend the verification for a period not exceeding five (5) years after the</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 23</b> <b>Period provere imovine</b></p> <p>1. Provera imovine se vrši za imovinu koju je službeno lice steklo tokom vršenja javne funkcije.</p> <p>2. Izuzetno, kada Biro oceni ili utvrdi da je imovina službenog lica stečena nakon vršenja javne funkcije u znatnoj meri veća od zakonitih prihoda ili imovine koju službeno lice steklo tokom vršenja javne funkcije, Biro može proširiti proveru i za period ne duže od pet (5) godina od kada javni službenik više ne obavlja javnu funkciju</p>

<p>të gjatë se pesë (5) vjeçare pasi që zyrtari publik nuk ushtron më funksionin publik.</p> <p>3. Në rastet kur personi zyrtar ka pasur ndërprerje kohore në ushtrimin e funksionit publik, periudha e verifikimit përfshin kohën prej emërimit të parë deri në pushimin e funksionit të fundit publik.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 24</b> <b>Procedura në Byro</b></p> <p>1. Kur Drejtori i Përgjithshëm vendosë për fillimin e procedurës sipas nenit 19, të këtij ligji, Byroja fillon procedurën e verifikimit dhe:</p> <p>1.1. kërkon, mbledhë, hulumton dhe analizon dokumentacionin dhe informatat tjera relevante për rastin, në përputhje me nenin 20 të këtij ligji dhe përgjatë ndërmarrjes së këtyre veprimeve apo kurdo që është e nevojshme kërkon ndihmë nga institucionet e Republikës së Kosovës në pajtim me legjislacionin në fuqi;</p> <p>1.2. kërkon informatat nga pala në procedurë dhe subjektet nga neni 21 i këtij ligji;</p>	<p>official has ceased to hold the public function.</p> <p>3. In cases where the official person has had a time break in the exercise of the public function, the verification period includes the time from the first appointment to the termination of the last public function.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 24</b> <b>Procedure before the Bureau</b></p> <p>1. When the General Director decides to initiate a procedure according to Article 19 of this Law, the Bureau shall initiate the verification procedure and:</p> <p>1.1. request, collect, research and analyze the documentation and other relevant information for the case, pursuant to Article 20 of this Law and during the undertaking of such actions or whenever necessary, request assistance from the institutions of the Republic of Kosovo in accordance with the legislation into force;</p> <p>1.2. request information from the party to procedure and the entities from Article 21 of this Law;</p>	<p>3. U slučaju da je službeno lice imalo prekid u vršenju javne funkcije, period provere obuhvata vreme od prvog imenovanja do prestanka poslednje javne funkcije.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 24</b> <b>Postupak u Birou</b></p> <p>1. Kada generalni direktor odluči da pokrene postupak prema članu 19. ovog zakona, Biro pokreće postupak provere i:</p> <p>1.1. traži, prikuplja, istražuje i analizira dokumentaciju i druge relevantne informacije o slučaju u skladu sa članom 20. ovog zakona i tokom preduzimanja ovih radnji ili kad god je potrebno, traži pomoć od institucija Republike Kosovo u skladu sa važećim zakonodavstvom;</p> <p>1.2. traži informacije od stranke u postupku i subjekata iz člana 21. ovog zakona;</p>
---	--	--

<p>1.3. ekzaminon rrethanat që kanë lidhje me rastin;</p> <p>1.4. mund të ftojë palën në procedurë për të dhënë dëshmi, me qëllim të identifikimit të pasurive tjera apo sqarimit të dyshimeve mbi pasurinë në verifikim.</p> <p>2. Procedura e verifikimit zhvillohet nga zyrtari i Byrosë të cilit i caktohet lënda me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm.</p> <p>3. Të gjitha informatat, dokumentet, faktet, provat, dëshmitë, që mblidhen nga zyrtari i Byrosë, duhet të mblidhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>4. Nëse gjatë procedurës së verifikimit, vërehet se pasuria është bartur tek ndonjë palë e tretë, atëherë zyrtari i Byrosë do të kërkojë nga Drejtori i Përgjithshëm që vendimi për verifikim të pasurisë të zgjerohet edhe tek ato palë të treta.</p> <p>5. Nga të dhënat e mbledhura sipas paragrafit 1 të këtij neni, Byroja liston pasurinë e palës në procedurë.</p> <p>6. Pas listimit të pasurisë, pala në procedurë ftohet të ofrojë prova dhe të dhëna për të justifikuar prejardhjen e pasurisë së listuar, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh.</p>	<p>1.3. examine the circumstances relevant to the case;</p> <p>1.4. may invite the party to the procedure to give testimony, in order to identify other assets or clarify doubts about the assets under verification.</p> <p>2. The verification procedure shall be conducted by the Bureau official to whom the case is assigned by the decision of the General Director.</p> <p>3. All information, documents, facts, evidence, testimonies collected by the Bureau officer must be collected in accordance with the legislation into force.</p> <p>4. If, during the verification procedure, it is noticed that the assets have been transferred to a third party, then the Bureau official will ask the General Director that the decision to verify the assets be extended to those third parties as well.</p> <p>5. From the data collected under paragraph 1 of this Article, the Bureau shall list the assets of the party to the procedure.</p> <p>6. After listing the assets, the party to procedure shall be invited to provide evidence and data to justify the origin of the listed assets within sixty (60) days.</p>	<p>1.3. ispituje okolnosti koje se odnose na slučaj;</p> <p>1.4. može pozvati stranku u postupku da da iskaz, u cilju identifikacije druge imovine ili pojašnjenja sumnje u vezi imovine koja je predmet provere.</p> <p>2. Postupak provere sprovodi službenik Biroa kome je predmet dodeljen odlukom generalnog direktora.</p> <p>3. Sve informacije, dokumenta, činjenice, dokaze, iskaze, koje prikuplja službenik Biroa, moraju se prikupiti u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p> <p>4. Ako se tokom postupka provere uoči da je imovina prenet na treće lice, službenik Biroa zatražiće od generalnog direktora da se odluka o proveri imovine proširi i na ta treća lica.</p> <p>5. Iz prikupljenih podataka iz stava 1. ovog člana, Biro označuje imovinu stranke u postupku.</p> <p>6. Nakon označavanja imovine, stranka u postupku se poziva da u roku od šezdeset (60) dana dostavi dokaze i podatke kojima opravdava poreklo označene imovine.</p>
--	--	--

<p>7. Në rast se nga të dhënat e mbledhura nga procedura e verifikimit dhe të dhënat, provat dhe dëshmitë e ofruara nga pala në procedurë, zyrtari i Byrosë vëren se nuk ka shpërputhje në mes të të hyrave dhe pasurisë, apo shpërputhja në mes të të hyrave dhe pasurisë nuk tejkalon vlerën prej njëzetepesë mijë (25.000) euro, atëherë zyrtari i Byrosë propozon mbylljen e rastit. Propozimi i arsyetuar për mbylljen e rastit i dorëzohet Drejtorit të Përgjithshëm, i cili më pas nxjerr vendim për mbylljen e rastit.</p>	<p>7. If from the data collected through the verification procedure and the data, evidence and testimony provided by the party to procedure, the Bureau official notices that there is no discrepancy between income and assets, or discrepancy between income and assets does not exceed the value of twenty-five thousand (25.000) Euro, the Bureau officer shall propose to close the case. The reasoned proposal for closing the case shall be submitted to the General Director, who then shall issue a decision to close the case.</p>	<p>7. U slučaju da iz podataka prikupljenih postupkom provere i podataka, dokaza i iskaza koje je stranka u postupku pružila, službenik Biroa uoči da ne postoji nesklad između prihoda i imovine, odnosno nesklad između prihoda i imovine ne prelazi vrednost od dvadeset pet hiljada (25.000) evra, onda službenik Biroa predlaže zatvaranje predmeta. Obrazloženi predlog za zatvaranje predmeta podnosi se generalnom direktoru, koji potom donosi odluku o zatvaranju predmeta.</p>
<p>8. Në rast se nga të dhënat e mbledhura nga procedura e verifikimit, provat dhe dëshmitë e ofruara nga pala në procedurë, zyrtari i Byrosë vëren se arrihet të përmbushet standardi civil i vlerësimit të gjasave dhe se ka shpërputhje në mes të të hyrave dhe pasurisë që tejkalon vlerën prej njëzetepesë mijë (25.000) euro, atëherë zyrtari i Byrosë propozon dërgimin e çështjes në Gjykatë për konfiskim. Propozimi i arsyetuar për dërgimin e çështjes në Gjykatë për konfiskim, i dorëzohet Drejtorit të Përgjithshëm, i cili më pas parashtron propozim për konfiskim.</p>	<p>8. If from the data collected from the verification procedure and the data, evidence and testimony provided by the party to procedure, the Bureau official assesses that the civil standard of the balance of probabilities is met and there is a discrepancy between income and assets exceeding twenty-five thousand (25.000) Euro, then the Bureau official shall propose to send the case to the court for confiscation. The reasoned proposal to refer the case to the Court for confiscation shall be submitted to the Director General, who shall then submit a proposal for confiscation.</p>	<p>8. U slučaju da iz podataka prikupljenih postupkom provere i podataka, dokaza i iskaza koje je stranka u postupku pružila, službenik Biroa uoči da postoji nesklad između prihoda i imovine koji prelazi vrednost od dvadeset pet hiljada (25.000) evra, onda službenik Biroa predlaže da se predmet prosledi sudu na oduzimanje. Obrazloženi predlog za prosleđivanje predmeta sudu na oduzimanje podnosi se generalnom direktoru, koji potom podnosi predlog za oduzimanje.</p>
<p>9. Në rast se pala në procedurë nuk i përgjigjet ftesës së Byrosë dhe vlera e pasurisë së listuar është më e lartë se</p>	<p>9. In case the party to procedure fails to respond to the Bureau invitation and the value of the listed assets is higher than</p>	<p>9. U slučaju da se stranka u postupku ne odazove pozivu Biroa, a vrednost popisane imovine je veća od dvadeset pet hiljada</p>

<p>njëzetepesëmijë (25.000) euro, si dhe është përmbushur standardi sipas paragrafit 8 të këtij neni, atëherë supozohet se pasuria e listuar është fituar në mënyrë të pajustificueshme. Zyrtari i Byrosë propozon dërgimin e çështjes në Gjykatë për konfiskim. Propozimi i arsyetuar për dërgimin e çështjes në Gjykatë për konfiskim, i dorëzohet Drejtorit të Përgjithshëm, i cili më pas parashtron propozim për konfiskim.</p> <p>10. Bashkë me propozimin për konfiskim, Byroja i përcjell Gjykatës listën e pasurive, provat materiale që ka në dosjen e lëndës dhe provat e ofruara nga pala në procedurë, nëse ka të tilla.</p> <p>11. Kurdo gjatë procedurës së verifikimit, Byroja mund të paraqes para Gjykatës kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme të sigurimit të pasurisë në verifikim, në përputhje me nenin 25 të këtij ligji.</p> <p>12. Në rast se Byroja merr vendim për mbylljen e rastit dhe pushimin e procedurës së verifikimit, menjëherë e njofton Gjykatën kur ka masë të përkohshme të sigurimit të pasurisë në verifikim.</p> <p>13. Në rast se kurdo gjatë procedurës së verifikimit, pala në procedurë humbë zotësinë e veprimet ose vdes, Byroja i kërkon</p>	<p>twenty-five thousand (25.000) Euro, and the standard according to paragraph 8 of this Article is met, then it is assumed that the listed assets have been acquired unjustifiably. The Bureau officer shall propose referring the case to the Court for confiscation. The reasoned proposal to refer the case to the Court for confiscation shall be submitted to the Director General, who shall then submit a proposal for confiscation.</p> <p>10. The Bureau shall, along with the proposal for confiscation, forward to the court a list of assets, the material evidence in the case file and the evidence provided by the party to procedure, if any.</p> <p>11. At any time during the verification period, the Bureau may submit to the court a request for imposing an interim security measure on the assets under verification, in accordance with Article 25 of this Law.</p> <p>12. Where the Bureau decides to close the case and terminate the verification procedure, it shall immediately notify the court when there is an interim security measure on the assets under verification.</p> <p>13. If at any time during the verification procedure, the party in the procedure loses the capacity to act or dies, the Bureau</p>	<p>(25.000) evra, te da je ispunjen standard iz stava 8. ovog člana, smatra se da je označena imovina neopravdano stečena. Službenik Biroa predlaže da se predmet prosledi sudu na oduzimanje. Obrazloženi predlog za prosljeđivanje predmeta sudu na oduzimanje podnosi se generalnom direktoru, koji potom podnosi predlog za oduzimanje.</p> <p>10. Uz predlog za oduzimanje, Biro dostavlja sudu spisak imovine, materijalne dokaze koje ima u spisima predmeta i dokaze koje je stranka u postupku dostavila, ako ih ima.</p> <p>11. Biro može u svako doba u toku postupka provere podneti sudu zahtev za određivanje privremene mere obezbeđenja imovine koja je predmet provere, u skladu sa članom 25. ovog zakona.</p> <p>12. U slučaju da Biro donose odluku o zatvaranju predmeta i obustavi postupka provere, isti odmah obaveštava sud ako postoji privremena mera obezbeđenja imovine koja je predmet provere.</p> <p>13 U slučaju da u bilo kom trenutku u toku postupka provere stranka u postupku izgubi poslovnu sposobnost ili umre, Biro traži od</p>
---	--	--



<p>Gjykatës caktimin e një përfaqësuesi të përkohshëm të pasurisë së palës.</p> <p>14. Byroja duhet të zhvillojë procedurën e verifikimit të pasurisë brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh nga dita e nxjerrjes së vendimit nga paragrafi 2 i këtij neni.</p> <p>15. Në rast se çështja është e komplikuar, atëherë zyrtari i Byrosë duhet të kërkojë nga Drejtori i Përgjithshëm zgjatjen e afatit nga paragrafi 14 i këtij neni për një periudhë shtesë jo më të gjatë se dyzetepesë (45) ditësh. Drejtori i Përgjithshëm vendosë për pranimin apo refuzimin e kërkesës, pasi që të analizojë kompleksitetin e çështjes. Refuzimi i kërkesës për afat shtesë, nënkupton për zyrtarin e Byrosë përfundimin e procedurës së verifikimit brenda afatit nga paragrafi 14 i këtij neni.</p> <p>16. Përjashtimisht nga paragrafët 14 dhe 15 të këtij neni, procedura e verifikimit të pasurisë mund të zgjasë deri në një (1) vit kur procedura është e varur nga kërkesa për bashkëpunim juridik ndërkombëtar.</p> <p>17. Procedura e verifikimit të pasurisë së pajustificueshme përcaktohet me akt nënligjor.</p>	<p>requests the Court to appoint a temporary representative of the party's assets.</p> <p>14. The Bureau must conduct the verification procedure of assets within ninety (90) days from the day of issuing the decision from paragraph 2 of this Article.</p> <p>15. In case the matter is complex, the Bureau official must request from the General Director to have the deadline from paragraph 14 of this Article extended for an additional period not longer than forty-five (45) days. The Director General shall decide to grant or reject the request, after analysing the complexity of the case. Rejection of the request for an additional deadline shall mean for the Bureau officer the completion of the verification procedure within the deadline from paragraph 14 of this Article.</p> <p>16. Notwithstanding paragraphs 14 and 15 of this Article, the asset verification procedure may take up to one (1) year when the procedure depends on the request for international legal cooperation.</p> <p>17. The procedure for verification of unjustifiable assets shall be determined by a sub-legal act.</p>	<p>suda da imenuje privremenog zastupnika za imovinu stranke.</p> <p>14. Biro je dužan da sprovede postupak provere imovine u roku od devedeset (90) dana od dana donošenja odluke iz stava 2. ovog člana.</p> <p>15. U slučaju da je stvar složena, službenik Biroa mora zatražiti od generalnog direktora produženje roka iz stava 14. ovog člana za dodatni period ne duži od četrdeset pet (45) dana. Generalni direktor odlučuje o prihvatanju ili odbijanju zahteva nakon analize složenosti stvari. Za službenika Biroa odbijanje zahteva za dodatnim rokom znači okončanje postupka provere u roku iz stava 14. ovog člana.</p> <p>16. Izuzetno od st. 14. i 15. ovog člana, postupak provere imovine može trajati do jedne (1) godine ako postupak zavisi od zahteva za međunarodnu pravnu saradnju.</p> <p>17. Postupak provere neopravdane imovine utvrđuje se podzakonskim aktom.</p>
--	--	---

<b>KAPITULLI VI MASA E PËRKOHSHME DHE E SIGURIMIT</b>	<b>CHAPTER VI INTERIM SECURITY MEASURE</b>	<b>POGLAVLJE VI. PRIVREMENA MERA I MERA OBEZBEĐENJA</b>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 25</b> <b>Masa e përkohshme e sigurimit të pasurisë</b></p> <p>1. Kurdo përpara ose pas paraqitjes së propozimit për konfiskim, me propozimin e zyrtarit të Byrosë, Gjykata mund të caktojë masën e përkohshme të sigurimit të pasurisë, pa njoftim dhe dëgjim paraprak të palës në procedurë, po që se Byroja e bënë të besueshëm pretendimin për ekzistimin e pasurisë së pajustificueshme dhe se masa e përkohshme është e bazuar në prova të mbledhura në procedurën e verifikimit dhe është urgjente dhe se me veprim ndryshe, pasuria mund të tjetërsohet, asgjësohet apo në çfarëdo forme nuk do të jetë në dispozicion të atij personi.</p> <p>2. Masat e përkohshme dhe të sigurimit të pasurisë që mund të urdhërohen nga Gjykata janë, por nuk kufizohen në:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. ndalimin e tjetërsimit të pasurisë;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. ndalimin e përdorimit të sendit të konsumueshëm;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 25</b> <b>Interim security measure on the assets</b></p> <p>1. Whenever before or after the presentation of the proposal for confiscation, upon the proposal of the Bureau official, the Court may set the temporary measure of securing the asset, without prior notification and hearing of the party in the procedure, if the Bureau makes a credible claim for the existence of unjustifiable assets and that the temporary measure is based on evidence collected in the verification procedure and is urgent and that if acted otherwise, the assets can be alienated, destroyed or in any form will not be available to that person.</p> <p>2. Interim security measures on the assets that may be imposed by the court shall be, but not limited to:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. prohibition on alienation of assets;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. prohibition on the use of the consumable item;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 25</b> <b>Privremena mera obezbeđenja imovine</b></p> <p>1. U svakom trenutku pre ili posle podnošenja predloga za oduzimanje, na predlog službenika Biroa, sud može odrediti privremenu meru obezbeđenja imovine, bez prethodnog obaveštenja i saslušanja stranke u postupku, ako Biro učini verovatnim navod da je privremena mera zasnovana na dokazima prikupljenim u postupku i da je hitna, te i da se drugim radnjama imovina može otuđiti, uništiti ili u bilo kom obliku neće biti dostupna tom licu.</p> <p>2. Privremene mere i mere obezbeđenja imovine koje sud može odrediti su, ali se ne ograničavaju na:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. zabranu otuđenja imovine;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. zabranu korišćenja potrošne stvari;</p>

<p>2.3. ndalimin e disponimit me mjete monetare që gjinden në llogarinë bankare apo në para të gatshme. Kur mjetet monetare gjinden në para të gatshme, Gjykata urdhëron që mjetet e tilla të deponohen në një llogari bankare që e menaxhon Byroja, pa të drejtë të shfrytëzimit.</p> <p>3. Propozimi për caktimin e masës së përkohshme duhet të përmbajë:</p> <p>3.1. të dhënat e Byrosë;</p> <p>3.2. të dhënat e Gjykatës që i drejtohet;</p> <p>3.3. identifikimin e palës në procedurë;</p> <p>3.4. specifikimin e pasurisë ndaj të cilës kërkohet lëshimi i masës së përkohshme;</p> <p>3.5. arsyetimin e rrethanave që e bëjnë të besueshëm pretendimin se pasuria e tillë mund të tjetërsohet, asgjësohet apo në çfarëdo forme nuk do të jetë në dispozicion të atij personi.</p>	<p>2.3. prohibition on disposing of funds held in a bank account or in cash. When funds are available in cash, the court shall order that such funds be deposited in a bank account managed by the Bureau, without the right to be used.</p> <p>3. The proposal for imposing an interim measure must contain:</p> <p>3.1. the Bureau data;</p> <p>3.2. data of the court to which it is addressed;</p> <p>3.3. identification of the party to the procedure;</p> <p>3.4. specification of the assets for which the issuance of the interim measure is requested;</p> <p>3.5. justification of the circumstances that make the claim credible that such assets may be alienated, disposed of or otherwise will not be available to that person.</p>	<p>2.3. zabranu raspolaganja novčanim sredstvima koja se nalaze na bankovnom računu ili u gotovini. Ako su novčana sredstva u gotovini, sud nalaže da se ta sredstva deponuju na bankovni račun kojim upravlja Biro, bez prava korišćenja.</p> <p>3. Predlog za određivanje privremene mere mora sadržati:</p> <p>3.1. podatke Biroa;</p> <p>3.2. podatke suda kojem se upućuje;</p> <p>3.3. identitet stranke u postupku;</p> <p>3.4. specifikaciju imovine za koju se traži donošenje privremene mere;</p> <p>3.5. obrazloženje okolnosti koje čine verovatnim navod da se takva imovina može otuđiti, uništiti ili u bilo kom obliku neće biti dostupna tom licu.</p>
--	--	--

<p align="center"><b>Neni 26</b> <b>Vendimi për masën e përkohshme të sigurimit të pasurisë</b></p>	<p align="center"><b>Article 26</b> <b>Decision on the interim security measure on the assets</b></p>	<p align="center"><b>Član 26</b> <b>Odluka o privremenoj meri obezbeđenja imovine</b></p>
<p>1. Gjykata duhet të vendosë lidhur me propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit të pasurisë brenda shtatëdhjetë e dy (72) orësh nga pranimi i propozimit:</p> <p>1.1. Gjykata e miraton propozimin për caktimin e masës së përkohshme dhe me aktvendim cakton masën e përkohshme të sigurimit të pasurisë, kur konstaton se masa e përkohshme e sigurimit të pasurisë është e bazuar dhe urgjente dhe se me veprim ndryshe, pasuria mund të tjetërsohet, asgjësohet apo në çfarëdo forme nuk do të jetë në dispozicion të atij personit;</p> <p>1.2. Gjykata me aktvendim e refuzon propozimin për caktimin e masës së përkohshme kur vlerëson se rrethanat e paraqitura në propozimin për caktimin e masës së përkohshme nuk e bëjnë të besueshëm pretendimin se pasuria mund të tjetërsohet, asgjësohet apo në çfarëdo forme të mos jetë në dispozicion të personit.</p> <p>2. Kundër aktvendimit nga paragrafi 1 nën-paragrafi 1.2 i këtij neni, zyrtari i Byrosë ka të drejtë të parashtojë ankesë brenda dyzet e</p>	<p>1. The court shall decide on the proposal for imposing an interim security measure on the assets within seventy-two (72) hours from the receipt of the proposal:</p> <p>1.1. the Court shall approve the proposal for imposing the temporary measure and shall impose the temporary security measure on assets by a ruling when it finds that the temporary security measure on the assets is grounded and urgent and that by acting differently, the assets can be alienated, disposed of or otherwise will not be available to that person;</p> <p>1.2. the Court shall, by a ruling, reject the proposal for imposing an interim measure when it finds that the circumstances presented in the proposal for imposing an interim measure do not make credible claim that the assets can be alienated, disposed of or otherwise will not be available to that person.</p> <p>2. The Bureau officer shall be entitled to file an appeal against the ruling from paragraph 1, sub-paragraph 1.2 of this</p>	<p>1.O predlogu za određivanje privremene mere obezbeđenja imovine sud je dužan da odluči u roku od sedamdeset dva (72) časa od časa prijema predloga:</p> <p>1.1. sud usvaja predlog za određivanje privremene mere i rešenjem određuje privremenu meru obezbeđenja imovine, ako utvrdi da je privremena mera obezbeđenja imovine osnovana i hitna i da se u suprotnom imovina može otuđiti, uništiti ili u bilo kom obliku neće biti dostupna tom licu;</p> <p>1.2. sud rešenjem odbija predlog za određivanje privremene mere ako oceni da okolnosti iznete u predlogu za određivanje privremene mere ne učine verovatnim navod da se imovina može otuđiti, uništiti ili u bilo kom obliku neće biti dostupna tom licu.</p> <p>2. Protiv rešenja iz stava 1. podstav 1.2. ovog člana, službenik Biroa ima pravo žalbe u roku od četrdeset osam (48) časova od časa</p>

<p>tetë (48) orësh nga pranimit i aktvendimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së shkallës së dytë nëpërmjet Gjykatës së shkallës së parë. Ankesa nuk ka efekt pezullues. Gjykata e shkallës së dytë vendos lidhur me ankesën brenda njëzet e katër (24) orësh nga pranimit i ankesës.</p> <p>3. Gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosjes sipas ankesës, ka të drejtë ta refuzojë ankesën apo ta ndryshojë aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë. Në rast se e ndryshon aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë, atëherë Gjykata e shkallës së dytë urdhëron masën e sigurimit të pasurisë, duke lëshuar aktvendim sipas paragrafi 1 nën-paragrafi 1.2 të këtij neni.</p> <p>4. Vendimi i lëshuar nga Gjykata e shkallës së parë apo Gjykata e shkallës së dytë sipas paragrafit 1 dhe 3 të këtij neni, i dërgohet menjëherë organit kompetent që mban regjistrin përkatës për atë pasuri, si Agjencisë Kadastrale, Odës së Noterëve, Odës së Përmbartuesve, Qendrës për Regjistrimin e Automjeteve, Bankës Qendrore të Kosovës, apo çdo institucioni tjetër kompetent, i cili detyrohen ta zbatojë urdhrin e tillë.</p> <p>5. Aktvendimin nga paragrafi 1 i këtij neni Gjykata, ia dërgon menjëherë personit ndaj</p>	<p>Article, within forty-eight (48) hours from the receipt of the ruling. The appeal shall be filed with the second instance court through the first instance court. The appeal shall not stay the execution. The second instance court shall rule on the appeal within twenty-four (24) hours from the receipt of the appeal.</p> <p>3. The second instance court shall, when ruling on the appeal, have the right to reject the appeal or amend the ruling of the first instance court. In case it amends the ruling of the first instance court, the second instance court shall order the security measure on the assets, issuing a ruling according to paragraph 1, sub-paragraph 1.2 of this Article.</p> <p>4. The decision issued by the first instance court or the second instance court under paragraphs 1 and 3 of this Article shall be promptly sent to the competent body that maintains the relevant register for that asset, such as the Cadastral Agency, Notary Chamber, Chamber of Enforcement Agents, Vehicle Registration Centre, Central Bank of Kosovo, or any other competent institution, which are obliged to implement such an order.</p> <p>5. The ruling from paragraph 1 of this Article shall be promptly sent by the court</p>	<p>prijema rešenja. Žalba se izjavljuje drugostepenom sudu preko prvostepenog suda. Žalba nema suspenzivno dejstvo. Drugostepeni sud odlučuje o žalbi u roku od dvadeset četiri (24) časa od časa prijema žalbe.</p> <p>3. Prilikom odlučivanja o žalbi drugostepeni sud ima pravo odbiti žalbu ili preinačiti rešenje prvostepenog suda. U slučaju preinačenja rešenja prvostepenog suda, drugostepeni sud određuje meru obezbeđenja imovine rešenjem iz stava 1. podstav 1.2. ovog člana.</p> <p>4. Odluka prvostepenog ili drugostepenog suda iz st. 1. i 3. ovog člana, odmah se dostavlja nadležnom organu koji vodi odgovarajući registar za tu imovinu, kao što su Katastarska agencija, Javnobeležnička komora, Komora izvršitelja, Centar za registraciju vozila, Centralna banka Kosova ili bilo koja druga nadležna institucija koja je dužna da sprovede takav nalog.</p> <p>5. Rešenje iz stava 1. ovog člana sud odmah upućuje licu protiv čije imovine je određena</p>
--	---	---

<p>pasurisë së të cilit është caktuar masa e përkohshme e sigurimit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 27</b> <b>Kundërshtimi i masës së përkohshme të sigurimit të pasurisë</b></p> <p>1. Personi ndaj pasurisë së të cilit është caktuar masa e përkohshme e sigurimit të pasurisë, mund të kundërshtojë caktimin kësaj mase brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i vendimit. Kundërshtimi duhet të jetë i arsyetuar.</p> <p>2. Kur personi ndaj pasurisë së të cilit është caktuar masa e përkohshme e sigurimit të pasurisë nuk ka kundërshtuar caktimin e kësaj mase, aktvendimi për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit të pasurisë mbetet në fuqi deri në marrjen e një vendimi tjetër mbi pasurinë.</p> <p>3. Kur paraqitet kundërshtim, Gjykata duhet të caktojë seancë dëgjimore brenda shtatë (7) ditësh nga pranimi i kundërshtimit.</p> <p>4. Gjykata në seancën për të vendosur lidhur me kundërshtimin, fton: zyrtarin e Byrosë, kundërshtuesin e masës së përkohshme dhe palët e treta. Palët mund të ftohen</p>	<p>to the person against whose assets the interim security measure has been imposed.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 27</b> <b>Objection to the interim security measure on the assets</b></p> <p>1. The person against whose assets the interim security measure on the assets has been imposed, may object to the imposition of such measure within fifteen (15) days from the receipt of the decision. The objection must be reasoned.</p> <p>2. When the person against whose assets the interim security measure is imposed has not objected to the imposition of such measure, the order to impose the interim security measure on the assets shall remain in force until another decision on the assets is rendered.</p> <p>3. When an objection is filed, the court shall schedule a hearing within seven (7) days from the receipt of the objection.</p> <p>4. In the hearing to decide on the objection, the court invites: The Bureau officer, the opponent of the temporary measure and the</p>	<p>privremena mera obezbeđenja.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 27</b> <b>Prigovor na privremenu meru obezbeđenja imovine</b></p> <p>1. Lice protiv čije imovine je određena privremena mera obezbeđenja imovine može uložiti prigovor na određivanje ove mere u roku od petnaest (15) dana od dana prijema odluke. Prigovor mora biti obrazložen.</p> <p>2. Ako lice protiv čije imovine je određena privremena mera obezbeđenja imovine nije uložilo prigovor na određivanje ove mere, rešenje o određivanju privremene mere obezbeđenja imovine ostaje na snazi do donošenja druge odluke o imovini.</p> <p>3. Ako je uložen prigovor, sud mora zakazati ročište u roku od sedam (7) dana od dana prijema prigovora.</p> <p>4. Na ročište za odlučivanje o prigovoru sud poziva: službenika Biroa, podnosioca prigovora na određivanje privremene mere i</p>
---	---	--

<p>personalisht ose përmes përfaqësuesve të tyre.</p> <p>5. Në seancën për të vendosur lidhur me kundërshtimin, fillimisht, i kërkohet parashtruesit të kundërshtimit të masës së përkohshme, si dhe palës së tretë, të argumentojë pretendimet e paraqitura në kundërshtim, përmes paraqitjes së provave sa i përket besueshmërisë dhe mungesës së rrezikut për pasurinë.</p> <p>6. Byroja mund të ofrojë prova dhe argumente shtesë për të bërë të besueshme se masa e përkohshme sigurimit të pasurisë është e bazuar dhe urgjente dhe se me veprim ndryshe, pasuria mund të tjetërsohet, asgjësohet apo në çfarëdo forme nuk do të jetë në dispozicion të atij personit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 28</b> <b>Masa e sigurimit të pasurisë</b></p> <p>1. Pas mbajtjes së seancës dëgjimore, Gjykata nxjerr aktvendim të veçantë me të cilin:</p> <p>1.1. anulon aktvendimin me të cilin ka caktuar masën e përkohshme të sigurimit e pasurisë sipas nenit 26 të këtij ligji;</p>	<p>third parties. The parties may be invited in person or through their representatives.</p> <p>5. In the hearing to decide on the objection, the applicant for the interim measure, as well as the third party, shall initially be asked to argue the allegations presented in the objection, by presenting evidence regarding the credibility and lack of risk for assets.</p> <p>6. The Bureau may provide additional evidence and arguments to make it credible that the interim security measure on the assets is reasonable and urgent and that by acting otherwise, the assets may be alienated, disposed of or otherwise will not be available to that person.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 28</b> <b>Security measure on the assets</b></p> <p>1. After holding the hearing, the Court shall issue a special ruling on:</p> <p>1.1. annulling the ruling by which it imposed the interim security measure on the assets pursuant to Article 26 of this Law;</p>	<p>treća lica. Strane mogu biti pozvane lično ili preko svojih zastupnika.</p> <p>5. Na ročištu za odlučivanje o prigovoru, prvenstveno podnosilac prigovora na privremenu meru, kao i treće lice, dužni su da obrazlože navode iz prigovora, izvođenjem dokaza u pogledu verodostojnosti i odsustvu opasnosti po imovinu.</p> <p>6. Biro može izneti dodatne dokaze i argumente da bi učinio verovatnim da je privremena mera obezbeđenja imovine osnovana i hitna i da se u suprotnim imovina može otuđiti, uništiti ili u bilo kom obliku neće biti dostupna licu.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 28</b> <b>Mera obezbeđenja imovine</b></p> <p>1. Nakon održanog ročišta, sud donosi posebno rešenje kojim:</p> <p>1.1. poništava rešenje kojim je odredio privremenu meru obezbeđenja imovine iz člana 26. ovog zakona;</p>
--	---	--

<p>1.2. lë në fuqi masën e përkohshme të sigurimit të pasurisë sipas nenit 26 të këtij ligji; ose</p> <p>1.3. zëvendëson masën e përkohshme të sigurimit të pasurisë sipas nenit 26 të këtij ligji me lloj tjetër të masës së sigurimit, kur konstaton se vazhdojnë të ekzistojnë rrethanat që e bëjnë të besueshëm pretendimin se ekziston rreziku se pasuria mund të tjetërsohet, asgjësohet apo në çfarëdo forme nuk do të jetë në dispozicion të atij personi.</p> <p>2. Aktvendimi nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të përmbaj:</p> <p>2.1. Hyrjen, ku përcaktohet emërtimi i Gjykatës, data e mbajtjes së seancës, faktin se seanca ka qenë publike apo e mbyllur, palët të cilave u referohet, pasurinë ndaj të cilës caktohet masa e përkohshme, llojin e masës me të cilën sigurohet pasuria, si dhe datën e përpilimi;</p> <p>2.2. Dispozitivin, ku përcaktohet nëse është caktuar masa e përkohshme ndaj pasurisë, duke specifikuar pasurinë që i nënshtrohet masës së tillë, si dhe faktin se masa e tillë ka efekt deri në përfundimin e procedurës së verifikimit të pasurisë apo procedurës së konfiskimit të pasurisë;</p>	<p>1.2. keeping in force the interim security measure on the assets pursuant to Article 26 of this Law; or</p> <p>1.3. replacing the interim security measure on the assets pursuant to Article 26 of this Law by another type of security measure, when it finds that circumstances making credible the claim that there is a risk that the assets may be alienated, disposed of or otherwise will not be available to that person continue to exist.</p> <p>2. The ruling from paragraph 1 of this Article shall contain:</p> <p>2.1. the introductory part, determining the name of the court, the date of the hearing, the fact that the hearing was public or closed, the parties to whom it refers, the assets against which the interim measure is imposed, the type of measure by which the assets are secured, and the date of compilation;</p> <p>2.2. the enacting clause, determining whether the interim measure has been imposed on the assets, specifying the assets subject to such a measure, as well as the fact that such a measure has effect until the completion of the procedure of</p>	<p>1.2. ostavlja na snazi privremenu meru obezbeđenja imovine iz člana 26. ovog zakona;</p> <p>1.3. zamenjuje privremenu meru obezbeđenja imovine iz člana 26. ovog zakona drugom vrstom mere obezbeđenja, ako utvrdi da i dalje postoje okolnosti koje čine verovatnim da postoji opasnost da imovina može biti otuđena, uništena ili u bilo kom obliku neće biti dostupna tom licu.</p> <p>2. Rešenje iz stava 1. ovog člana mora sadržati:</p> <p>2.1. preambulu, koja sadrži naziv suda, datum održavanja ročišta, činjenicu da je ročište bilo javno ili zatvoreno za javnost, stranke na koje se odnosi, imovinu protiv koje se određena privremena mera, vrstu mere kojom se obezbeđuje imovina, kao i datum sastavljanja;</p> <p>2.2. dispozitiv, koji sadrži naznaku da li je određena privremena mera na imovinu, označujući imovinu koja je predmet te mere, kao i činjenicu da takva mera ima dejstvo do okončanja postupka provere imovine ili postupka oduzimanja imovine;</p>
--	--	--



<p>2.3. Arsyetimin, ku pasqyrohet rrjedha e procedurës se verifikimit, propozimin e Byrosë dhe urdhrin për masën e përkohshme ndaj pasurisë, kohën e caktimit të seancës dëgjimore, pretendimet e palëve në seancën dëgjimore, provat që janë propozuar nga ana e palëve, arsyet përse gjykata ka ardhur në konkluzion se rrethanat e parashtruara nga Byroja arsyetojnë masën ndaj pasurisë dhe se masa e tillë është e domosdoshme për të shmangur tjetërsimin, asgjësimin, apo për të shmangur që në çfarëdo forme pasuria të mos jetë në dispozicion të atij personi.</p> <p>3. Aktvendimi nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet t'i dorëzohet palëve, çdo pale të tretë të njohur që ka pretenduar interes juridik mbi pasurinë, si dhe organit kompetent që mban regjistrin përkatës për atë pasuri, si Agjencisë Kadastrale, Odës së Noterëve, Odës së Përmbaresve, Qendrës për Regjistrimin e Automjeteve, Bankës Qendrore të Kosovës, apo çdo institucioni tjetër kompetent, të cilat detyrohen të zbatojnë urdhrin e tillë.</p>	<p>verification of assets or the procedure of confiscation of assets;</p> <p>2.3. the reasoning, reflecting the course of the verification procedure, the proposal of the Bureau and the order on the interim measure on the assets, the time of scheduling the hearing, the claims of the parties in the hearing, the evidence proposed by the parties, the reasons why the court came in conclusion that the circumstances set out by the Bureau justify the measure on the assets, and why such a measure is necessary to avoid alienation, disposal of or otherwise avoid the assets being available to that person.</p> <p>3. The ruling from paragraph 1 of this Article must be served on the parties, any known third party that has claimed legal interest in the assets, as well as the competent body that maintains the relevant register for that asset, such as the Cadastral Agency, Chamber of Enforcement Agents, Vehicle Registration Centre, Central Bank of Kosovo, or any other competent institution obliged to implement such an order.</p>	<p>2.3.obrazloženje, koje sadrži tok postupka provere, predlog Biroa i nalog za privremenu meru nad imovinom, vreme ročišta, navode stranaka na ročištu, dokaze koje su stranke predložile, razloge zbog kojih je sud došao do zaključka da okolnosti koje je Biro izneo opravdavaju meru nad imovinom, te da je takva mera neophodna da bi se izbeglo otuđenje, uništenje, odnosno da bi se izbegne da imovina u bilo kom obliku ne bude dostupna tom licu.</p> <p>3. Rešenje iz stava 1. ovog člana mora se dostaviti strankama, svakom poznatom trećem licu koje je tvrdilo da ima pravni interes na imovini, kao i nadležnom organu koji vodi odgovarajući registar za tu imovinu, kao što su Katastarska agencija, Javnobeležnička komora, Komora izvršitelja, Centar za registraciju vozila, Centralna banka Kosova, ili bilo koja druga nadležna institucija, koja je dužna da sprovede takav nalog.</p>
---	--	---

<p align="center"><b>Neni 29</b> <b>Ankesa kundër aktvendimit</b></p>	<p align="center"><b>Article 29</b> <b>Appeal against the Ruling</b></p>	<p align="center"><b>Član 29</b> <b>Žalba na rešenje</b></p>
<p>1. Kundër aktvendimit nga neni 28, paragrafi 1 i këtij ligji, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i aktvendimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së shkallës së dytë, nëpërmjet Gjykatës së shkallës së parë. Ankesa nuk ka efekt pezullues.</p> <p>2. Ankesa i dërgohet palës kundërshtare, përmes Gjykatës së shkallës së parë. Pala kundërshtare ka të drejtë të paraqesë përgjigje në ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh.</p> <p>3. Gjykata e shkallës së parë pas pranimit të përgjigjes, ankesën me të gjitha shkresat e lëndës ia dërgon gjykatës së shkallës së dytë.</p> <p>4. Gjykata e shkallës së dytë vendosë për ankesën në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita në të cilën i arrin përgjigja në ankesë apo përfundon afati për paraqitjen e saj.</p> <p>5. Me rastin e vendosjes sipas ankesës, gjykata e shkallës së dytë mund të:</p> <p>5.1. hedhë poshtë ankesën si të paafatshme apo të palejueshme;</p>	<p>1. The aggrieved party may file an appeal against the ruling from Article 28, paragraph 1 of this Law, within fifteen (15) days from the receipt of the ruling. The appeal shall be filed to the second instance court through the first instance court. The appeal shall not stay the execution.</p> <p>2. The appeal shall be served on the opposing party, through the first instance court. The opposing party shall have the right to file a response to the appeal within fifteen (15) days.</p> <p>3. After receiving the response, the first instance court shall forward the appeal with all the case files to the second instance court.</p> <p>4. The second instance court shall rule on the appeal within seven (7) days from the day on which the response to the appeal is received or the deadline for its submission expires.</p> <p>5. In deciding on the appeal, the second instance court may:</p> <p>5.1. dismiss the appeal as belated or inadmissible;</p>	<p>1. Protiv rešenja iz člana 28. stav 1. ovog zakona, nezadovoljna strana može izjaviti žalbu u roku od petnaest (15) dana od dana prijema rešenja. Žalba se podnosi drugostepenom sudu preko prvostepenog suda. Žalba nema suspenzivno dejstvo.</p> <p>2. Žalba se dostavlja protivnoj strani preko prvostepenog suda. Protivna strana ima pravo da podnese odgovor na žalbu u roku od petnaest (15) dana.</p> <p>3. Po prijemu odgovora, prvostepeni sud dostavlja žalbu sa svim spisima predmeta drugostepenom sudu.</p> <p>4. Drugostepeni sud odlučuje o žalbi u roku od sedam (7) dana od dana kada je stigao odgovor na žalbu ili isteka roka za podnošenje istog.</p> <p>5. Prilikom odlučivanja o žalbi drugostepeni sud može:</p> <p>5.1. odbaciti žalbu kao neblagovremenu ili nedozvoljenu;</p>

<p>5.2. prishë aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe çështjen e kthen në rivendosje në shkallë të parë;</p> <p>5.3. refuzojë ankesën si të pathemeltë dhe të vërtetojë aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë; ose</p> <p>5.4. ndryshojë aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të hapë seancë për të shqyrtuar drejtpërdrejt pretendimet ankimore.</p> <p>6. Kur Gjykata vendosë masën e sigurimit të pasurisë apo kur vendosë masë të përkohshme ndaj pasurisë dhe pasuria që i nënshtrohet masës së tillë krijon fryte, masa e urdhëruar shtrihet edhe ndaj fryteve.</p>	<p>5.2. quash the ruling of the first instance court and send the case back for retrial in the first instance;</p> <p>5.3. reject the appeal as unfounded and confirm the ruling of the first instance court; or</p> <p>5.4. amend the ruling of the first instance court and open a hearing to directly review the appellate claims.</p> <p>6. When the court imposes the security measure on the assets or when it imposes the interim measure on the assets and the assets subject to such a measure bears fruits, the measure imposed shall also extend to the fruits.</p>	<p>5.2. poništiti rešenje prvostepenog suda i vratiti predmet prvostepenom sudu na ponovno odlučivanje;</p> <p>5.3. odbiti žalbu kao neosnovanu i potvrditi rešenje prvostepenog suda; ili</p> <p>5.4. preinačiti rešenje prvostepenog suda i otvoriti raspravu za neposredno razmatranje žalbenih navoda.</p> <p>6. Ako sud odredi meru obezbeđenja imovine ili ako odredi privremenu meru na imovinu, a imovina, koja je predmet takve mere, stvara plodove, naložena mera se odnosi i na plodove.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 30</b> <b>Kohëzgjatja e masave</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 30</b> <b>Duration of measures</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 30</b> <b>Trajanje mera</b></p>
<p>1. Gjykata mund të urdhërojë masën për sigurimin e pasurisë në kohëzgjatje prej së paku nëntëdhjetë (90) ditësh dhe më së shumti gjashtë (6) muajsh, nga momenti kur aktvendimi për caktimin e masës ka marrë formën e prerë.</p> <p>2. Kur ndaj masës së përkohshme për sigurimin e pasurisë nuk është ushtruar kundërshtim në përputhje me nenin 27 të</p>	<p>1. The court may order the security measure on the assets for a period of at least ninety (90) days and a maximum of six (6) months, from the time when the ruling on imposing the measure has become final.</p> <p>2. When the interim security measure on the assets has not been objected in accordance with Article 27 of this Law, the</p>	<p>1. Sud može naložiti meru obezbeđenja imovine u trajanju od najmanje devedeset (90) dana i do najviše šest (6) meseci od pravosnažnosti rešenja o određivanju mere.</p> <p>2. Ako na privremenu meru obezbeđenja imovine nije podnet prigovor u skladu sa članom 27. ovog zakona, sud može odrediti</p>

<p>këtij ligji, Gjykata mund të urdhërojë masën e përkohshme për sigurimin e pasurisë në kohëzgjatje prej së paku nëntëdhjetë (90) ditësh dhe më së shumti deri në gjashtë (6) muaj, nga momenti kur aktvendimi për caktimin e masës ka marrë formën e prerë.</p> <p>3. Përfundimisht, Gjykata mund të urdhërojë masën e përkohshme për sigurimin e pasurisë, përkatësisht masën për sigurimin e pasurisë, në kohëzgjatje prej më së shumti një (1) viti, kur çështja është e varur nga kërkesa për bashkëpunim juridik ndërkombëtar.</p> <p>4. Nëse masa e përkohshme për sigurimin e pasurisë, përkatësisht masa për sigurimin e pasurisë është urdhëruar përpara paraqitjes së propozimit për konfiskim dhe kur Byroja nuk paraqet propozimin për konfiskim brenda afateve nga paragrafi 1, 2 dhe 3 i këtij neni, Gjykata menjëherë zyrtarisht apo me kërkesën e palës në procedurë, anulon masën e urdhëruar dhe urdhëron që pasuria t'i vihet në dispozicion palës.</p>	<p>Court may order the interim security measure on the assets for a period of at least ninety (90) days and a maximum of six (6) months, from the time when the ruling on imposing the measure has become final.</p> <p>3. Exceptionally, the Court may order the interim security measure on the assets, respectively the security measure on the assets, for a period of at most one (1) year, when the case deepens on the request for international legal cooperation.</p> <p>4. The interim security measure on the assets, respectively the security measure on the assets is ordered before the submission of the proposal for confiscation and when the Bureau does not submit the proposal for confiscation within the deadlines from paragraphs 1, 2 and 3 of this Article, the Court shall promptly and formally, at the request of the party to the proceedings, annul the ordered measure and order that the assets be made available to the party.</p>	<p>privremenu meru obezbeđivanja imovine u trajanju od najmanje devedeset (90) dana i do najviše šest (6) meseci od pravosnažnosti rešenja o određivanju mere.</p> <p>3. Izuzetno, sud može odrediti privremenu meru obezbeđenja imovine, odnosno meru obezbeđenja imovine u trajanju od najviše jedne (1) godine, kada predmet zavisi od zahteva za međunarodnu pravnu saradnju.</p> <p>4. Ako je privremena mera obezbeđenja imovine, odnosno mera obezbeđenja imovine određena pre podnošenja predloga za oduzimanje unutar rokova iz st. 1, 2. i 3. ovog člana, sud odmah, po službenoj dužnosti ili na zahtev stranke u postupku, ukida određenu meru i nalaže da se imovina stavi na raspolaganje stranci.</p>
--	--	--

<b>KAPITULLI VII PROPOZIMI PËR KONFISKIM</b>	<b>CHAPTER VII PROPOSAL FOR CONFISCATION</b>	<b>POGLAVLJE VII PREDLOG ZA ODUZIMANJE</b>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 31</b> <b>Paraqitja e propozimit për konfiskim</b></p> <p>1. Propozimi për konfiskim duhet të përmbaj:</p> <p>1.1. emrin e gjykatës;</p> <p>1.2. të dhënat e Byrosë;</p> <p>1.3. të dhënat e personit, pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet;</p> <p>1.4. të dhënat e palës së tretë kur pasuria e verifikuar ka kaluar te ai person;</p> <p>1.5. bazën ligjore;</p> <p>1.6. listën me secilën pasuri që propozohet të konfiskohet, duke specifikuar saktësisht, llojin dhe lartësinë e vlerës së pasurisë;</p> <p>1.7. çdo e dhënë që ka shërbyer në verifikimin e pasurisë sipas nenit 20 të këtij ligji;</p> <p>1.8. kërkesën për masë të sigurimit të pasurisë, nëse është e nevojshme.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 31</b> <b>Submission of the proposal for confiscation</b></p> <p>1. The proposal for confiscation must contain:</p> <p>1.1. the name of the court;</p> <p>1.2. the Bureau data;</p> <p>1.3. data of the person whose assets are proposed to be confiscated;</p> <p>1.4. data of the third party when the verified assets have passed to that person;</p> <p>1.5. legal basis;</p> <p>1.6. the list of each asset proposed to be confiscated, specifying exactly the type and amount of value of the assets;</p> <p>1.7. any data that has served in the verification of assets under Article 20 of this Law;</p> <p>1.8. if necessary, the request for security measure on the assets.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 31</b> <b>Podnošenje predloga za oduzimanje</b></p> <p>1. Predlog za oduzimanje imovine mora sadržati:</p> <p>1.1. naziv suda;</p> <p>1.2. podatke Biroa;</p> <p>1.3. podatke o licu čija se imovina predlaže za oduzimanje;</p> <p>1.4. podatke o trećem licu, ako je proverena imovina prešla na to lice;</p> <p>1.5. pravni osnov;</p> <p>1.6. spisak sa svakom imovinom koja se predlaže za oduzimanje, sa tačnom oznakom vrste i vrednosti imovine;</p> <p>1.7. svaki podatak koji je služio za proveru imovine prema članu 20. ovog zakona.</p> <p>1.8. zahtev za meru obezbeđenja imovine, ako je potrebno.</p>

<p>2. Propozimit duhet t'i bashkëngjiten të gjitha provat që Byroja ka shqyrtuar për pasurinë që i nënshtrohet propozimit për konfiskim.</p> <p>3. Byroja, propozimin për konfiskim të pasurisë, ia dorëzon Gjykatës në kopje të mjaftueshme për palën në procedurë, si dhe për çdo palë të tretë të njohur që ka interes juridik mbi pasurinë.</p> <p>4. Gjykata posa ta pranojë propozimin për konfiskim së bashku me provat, në afat prej tre (3) ditësh shqyrton nëse propozimi i përmbush kushtet ligjore nga paragrafi 1 i këtij neni.</p> <p>5. Nëse Gjykata konstaton se propozimi nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe i plotë, siç përcaktohet në paragrafin 1 këtij neni, me aktvendim e udhëzon Byronë që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh të bëjë përmirësimet dhe plotësimet e nevojshme.</p> <p>6. Nëse propozimi përmirësohet ose plotësohet dhe i dorëzohet Gjykatës brenda afatit të dhënë, do të konsiderohet se i është parashtruar Gjykatës në ditën kur është paraqitur për të parën herë.</p> <p>7. Propozimi do të konsiderohet se është tërhequr po qe se nuk i kthehet Gjykatës</p>	<p>2. All the evidence that the Bureau has examined the assets subject to the proposal for confiscation shall be enclosed to the proposal for confiscation.</p> <p>3. The Bureau shall submit the proposal for confiscation of assets to the Court in sufficient copies for the party to the procedure, as well as for any known third party that has a legal interest in the assets.</p> <p>4. The court shall, as soon as it receives the proposal for confiscation along with the evidence, examine within three (3) days whether the proposal meets the legal requirements from paragraph 1 of this Article.</p> <p>5. If the court finds that the request fails to be comprehensible and complete, as required by paragraph 1 of this Article, it shall issue a ruling instructing the Bureau to make corrections and amendments to the proposal within seven (7) days.</p> <p>6. If the proposal is corrected or amended and submitted to the court within the given deadline, it shall be considered that it was submitted to the court on the day when it was originally filed.</p> <p>7. The proposal will be considered withdrawn if it is not returned to the Court</p>	<p>2. Uz predlog moraju se priložiti svi dokazi koje je Biro razmatrao za imovinu koja je predmet predloga za oduzimanje.</p> <p>3. Biro podnosi sudu predlog za oduzimanje imovine u dovoljnom broju primeraka za stranku u postupku, kao i za svako poznato treće lice koje ima pravni interes na imovinu.</p> <p>4. Po prijemu predloga za oduzimanje, zajedno sa dokazima, sud u roku od tri (3) dana razmatra da li predlog ispunjava zakonske uslove iz stava 1. ovog člana.</p> <p>5. Ako sud utvrdi da zahtev nije razumljiv i potpun, kako je utvrđeno u stavu 1. ovog člana, rešenjem upućuje Biro da u roku od sedam (7) dana izvrši neophodne ispravke i dopune.</p> <p>6. Ako se predlog ispravi ili dopuni i dostavi sudu u datom roku, smatraće se da je podnet sudu na dan kada je po prvi put podnet.</p> <p>7. Predlog smatra se povučenim ako se u ostavljenom roku ne vrati sudu. Ako se</p>
---	--	--

<p>brenda afatit të dhënë. Nëse propozimi i kthehet Gjykatës pa u përmirësuar ose plotësuar, gjegjësisht pa u plotësuar, propozimi hidhet poshtë.</p> <p>8. Kur gjykata nxjerr aktvendim me të cilin konstaton tërheqje të propozimit apo e hedh poshtë atë, atëherë revokon çdo masë që është në fuqi ndaj pasurisë që i është nënshtruar verifikimit. Në rastet kur propozimi hidhet poshtë, i njëjti nuk mund të paraqitet në të ardhmen në asnjë rrethanë.</p> <p>9. Kur Gjykata konstaton se propozimi është parashtruar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, propozimin së bashku me të gjitha provat ia dërgon palës në procedurë dhe palës së tretë të njohur brenda shtatë (7) ditësh nga momenti i pranimit të propozimit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 32</b> <b>Kundërshtimi ndaj propozimit për konfiskim</b></p> <p>1. Pala në procedurë, pasi pranon propozimin për konfiskim së bashku me provat sipas nenit 31 të këtij ligji, kanë të drejtë të parashtrojnë kundërshtim me shkrim në gjykatën e shkallës së parë, brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i propozimit.</p>	<p>within the given deadline. If the proposal is returned to the Court without being improved or completed, i.e., without being completed, the proposal is rejected.</p> <p>8. When the court issues a ruling finding that the proposal is withdrawn or dismisses it, it shall revoke any measure that is in force against the assets subject to verification. In cases where the proposal is dismissed, the same cannot be presented in the future under any circumstances.</p> <p>9. When the court finds that the proposal has been filed in accordance with paragraph 1 of this Article, the proposal along with all the evidence shall be sent to the party to the procedure and the third party known, within seven (7) days from the receipt of the proposal.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 32</b> <b>Opposition to the proposal for confiscation</b></p> <p>1. The parties in the procedure, after receiving the proposal for confiscation along with the evidence under Article 31 of this Law, shall have the right to submit a written objection to the first instance court within thirty (30) days from the receipt of the proposal.</p>	<p>predlog vrati sudu neispravljen ili nadopunjen, odnosno nedovršen, predlog se odbacuje.</p> <p>8. Kada sud donese rešenje kojim utvrđuje povlačenje predloga ili isti odbacuje, onda ukida svaku meru koja je na snazi prema imovini koja je predmet provere. U slučaju da se predlog odbaci, isti se ni pod kojim okolnostima ne može ubuduće podneti.</p> <p>9. Kada sud utvrdi da je predlog podnet u skladu sa stavom 1. ovog člana, predlog, zajedno sa svim dokazima, dostavlja se stranci u postupku i poznatom trećem licu u roku od sedam (7) dana od dana prijema predloga.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 32</b> <b>Prigovor na predlog za oduzimanje</b></p> <p>1. Stranka u postupku, po prijemu predloga za oduzimanje, zajedno sa dokazima iz člana 31. ovog zakona, ima pravo da podnese pismeni prigovor prvostepenom sudu u roku od trideset (30) dana od prijema predloga za oduzimanje.</p>
--	---	--

<p>2. Kundërshtimi mund të parashtrohet, duke përfshirë por pa u kufizuar në arsytet e mëposhtme:</p> <p>2.1. pasuria që propozohet të konfiskohet ka prejardhje të justifikueshme;</p> <p>2.2. propozimi për konfiskim përfshinë pasurinë e cila nuk mund të përmbahet sipas ligjit;</p> <p>2.3. Byroja, në fazën e verifikimit të pasurisë, nuk ka marrë për bazë provat e ofruara nga pala në procedurë.</p> <p>3. Gjykata, kundërshtimin sipas paragrafit 1 të këtij neni, ia dërgon menjëherë Byrosë. Byroja mund të jap përgjigje me shkrim ndaj kundërshtimit brenda shtatë (7) ditësh nga pranimi i kundërshtimit.</p> <p>4. Pas pranimit të përgjigjes me shkrim nga Byroja, apo pas kalimit të afatit kur Byroja ka mundur të jap përgjigje, Gjykata, jashtë seancës, vlerëson kundërshtimin dhe nxjerr aktvendim të arsyetuar, me të cilin:</p> <p>4.1. hedhë poshtë propozimin e Byrosë dhe konstaton përfundimin e procedurës;</p>	<p>2. Objection may be submitted, including but not limited to the following reasons:</p> <p>2.1. the asset proposed to be confiscated has justified origin;</p> <p>2.2. the proposal for confiscation includes assets that cannot be enforced according to the law;</p> <p>2.3. the Bureau, during the asset verification phase, has not taken into account the evidence provided by the party to procedure.</p> <p>3. The court shall send the objection according to paragraph 1 of this Article to the Bureau promptly. The Bureau may provide a written response to the objection within seven (7) days from the receipt of the objection.</p> <p>4. Upon receipt of a written response from the Bureau, or after the deadline available to the Bureau to respond expires, the court shall examine the objection in an out-of-court hearing and issue a reasoned ruling on:</p> <p>4.1. dismissing the proposal of the Bureau and ascertaining the completion of the procedure;</p>	<p>2. Prigovor se može podneti, uključujući, ali ne ograničavajući se iz sledećih razloga:</p> <p>2.1. imovina koja se predlaže za oduzimanje ima opravdano poreklo;</p> <p>2.2. predlog za oduzimanje obuhvata imovinu koja se ne može izvršiti prema zakonu;</p> <p>2.3. Biro, u fazi provere imovine, nije uzeo u obzir dokaze koje je stranka ili treće lice pružilo u postupku;</p> <p>3. Sud odmah dostavlja Birou prigovor iz stava 1. ovog člana. Biro može dati pismeni odgovor na prigovor u roku od sedam (7) dana od dana prijema prigovora.</p> <p>4. Po prijemu pismenog odgovora Biroa ili po isteku roka u kojem je Biro mogao odgovoriti, sud, van rasprave, ocenjuje prigovor i donosi obrazloženo rešenje kojim:</p> <p>4.1. odbacuje predlog Biroa i utvrđuje kraj postupka;</p>
---	--	--



<p>4.2. refuzon kundërshtimin;</p> <p>4.3. pezullon shqyrtimin e propozimit për konfiskim në afat prej tridhjetë (30) ditësh dhe propozimin ia kthen Byrosë që t'i eliminojë shkeljet procedurale, duke e detyruar që pas afatit tridhjetë (30) ditor të njoftojë gjykatën se a mbetet pranë propozimit për konfiskim;</p> <p>5. Kundër aktvendimit nga paragrafi 4 i këtij neni pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh. Ankesa i drejtohet gjykatës së shkallës së dytë nëpërmjet gjykatës së shkallës së parë. Ankesa nuk ka efekt pezullues.</p> <p>6. Gjykata e shkallës së parë ia dërgon ankesën palës kundërshtare për të dhënë përgjigje në ankesë në afat prej shtatë (7) ditësh. Pasi që ta pranojë përgjigjen në ankesë, gjykata e shkallës së parë ia dërgon gjykatës së shkallës së dytë ankesën me të gjitha shkresat e lëndës.</p> <p>7. Gjykata e shkallës së dytë vendosë lidhur me ankesën në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të ankesës dhe me aktvendim të arsyetuar:</p>	<p>4.2. rejecting the objection;</p> <p>4.3. staying the examination of the proposal for confiscation within the term of thirty (30) days and returning the proposal to the Bureau to eliminate procedural violations, forcing it after the deadline of thirty (30) days to notify the court whether it maintains the proposal for confiscation;</p> <p>5. The aggrieved party shall have the right to file an appeal against the ruling from paragraph 4 of this Article within fifteen (15) days. The appeal shall be filed with the second instance court that issued the ruling. The appeal shall not stay the execution.</p> <p>6. The first instance court shall send the appeal on the opposing party to respond to the appeal within seven (7) days. After receiving the response to the appeal, the first instance court shall forward the appeal with all the case files to the second instance court.</p> <p>7. The second instance court shall rule on the appeal within seven (7) days from the day of receiving the appeal and issues a reasoned ruling on:</p>	<p>4.2. odbija prigovor;</p> <p>4.3. obustavlja razmatranje predloga za oduzimanje u roku od trideset (30) dana i vraća predlog Birou da otkloni proceduralne povrede, obavezujući ga da po isteku roka od trideset (30) dana obavesti sud da li ostaje pri predlogu za oduzimanje;</p> <p>5. Protiv rešenja iz stava 4. ovog člana, nezadovoljna stranka ima pravo žalbe u roku od petnaest (15) dana. Žalba se upućuje drugostepenom sudu preko prvostepenog suda. Žalba nema suspenzivno dejstvo.</p> <p>6. Prvostepeni sud dostavlja žalbu protivnoj strani da odgovori na žalbu u roku od sedam (7) dana. Po prijemu odgovora na žalbu, prvostepeni sud dostavlja žalbu sa svim spisima predmeta drugostepenom sudu.</p> <p>7. Drugostepeni sud odlučuje o žalbi u roku od sedam (7) dana od dana prijema žalbe i obrazloženim rešenjem:</p>
--	---	---

<p>7.1. Refuzon ankesën si të pabazuar dhe vërteton aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë;</p> <p>7.2. Aprovon ankesën si të bazuar, anulon aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe kthen çështjen në rivendosje ose</p> <p>7.3. Ndryshon aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe vendosë sipas ankesës.</p>	<p>7.1. rejecting the appeal as unfounded and upholding the ruling of the first instance court;</p> <p>7.2. granting the appeal as founded and annulling the ruling of the first instance court and sending the case back for retrial; or</p> <p>7.3. amending the ruling of the first instance court and ruling on the appeal.</p>	<p>7.1. odbija žalbu kao neosnovanu i potvrđuje rešenje prvostepenog suda;</p> <p>7.2. usvaja žalbu kao osnovanu, poništava rešenje prvostepenog suda i predmet vraća na ponovno odlučivanje; ili</p> <p>7.3. preinačuje rešenje prvostepenog suda i odlučuje po žalbi.</p>
<p><b>KAPITULLI VIII</b> <b>SEANCA E SHQYRTIMIT TË</b> <b>PROPOZIMIT PËR KONFISKIM</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 33</b> <b>Përgatitja e seancës së shqyrtimit të</b> <b>propozimit për konfiskim</b></p>	<p><b>CHAPTER VIII</b> <b>HEARING ON EXAMINATION OF</b> <b>THE PROPOSAL FOR</b> <b>CONFISCATION</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 33</b> <b>Preparation of the hearing on</b> <b>examination of the proposal for</b> <b>confiscation</b></p>	<p><b>POGLAVLJE VIII.</b> <b>GLAVNA RASPRAVA O PREDLOGU</b> <b>ZA ODUZIMANJE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 33</b> <b>Priprema glavne rasprave o predlogu za</b> <b>oduzimanje</b></p>
<p>1. Pas vendosjes lidhur me kundërshtimin ndaj propozimit për konfiskim, apo pas kalimit të afatit për kundërshtim, Gjykata cakton seancë për shqyrtimin e propozimit për konfiskim.</p> <p>2. Seancën për shqyrtimin e propozimit për konfiskim Gjykata e cakton me urdhër, i cili përmban:</p>	<p>1. After deciding on the objection of the parties to the proposal for confiscation, or after the expiration of the deadline for objection, the court shall schedule a hearing to examine the proposal for confiscation of assets.</p> <p>2. The hearing on examination of the proposal for confiscation shall be scheduled by a court order, containing:</p>	<p>1. Po donošenju odluke o prigovoru ili po isteku roka za prigovor, sud zakazuje glavnu raspravu o predlogu za oduzimanje.</p> <p>2. Sud naredbom zakazuje glavnu raspravu o predlogu za oduzimanje, koja sadrži:</p>

<p>2.1.ditën, orën dhe vendin e mbajtjes së seancës;</p> <p>2.2. propozimin për konfiskim;</p> <p>2.3. personat që do të thirren në seancë;</p> <p>2.4. çështje të tjera që mund të kenë rëndësi për shqyrtimin e propozimit për konfiskim.</p> <p>3. Kur propozimi për konfiskim përfshin masë të madhe të pasurisë apo kur lënda përfshin materiale të shumta për shqyrtim, Gjykata duhet që në urdhër të caktojë kohën e mbajtjes së seancës së vazhdueshme.</p> <p>4. Së bashku me urdhrin Gjykata i dërgon palëve ftesën për seancë. Kur seanca është caktuar për kohë të vazhdueshme, ftesa duhet të përmbaj edhe ditët në të cilat vazhdon seanca e shqyrtimit të propozimit për konfiskim. Ftesa duhet dërguar tetë (8) ditë para fillimit të seancës.</p> <p>5. Për dorëzimin e ftesave zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e ligjit përkatës për procedurën kontestimore.</p>	<p>2.1. the day, time and place of the hearing;</p> <p>2.2. proposal for confiscation;</p> <p>2.3. persons to be summoned to the hearing;</p> <p>2.4. other issues that may be relevant to the examination of the proposal for confiscation.</p> <p>3. When the proposal for confiscation involves a large amount of assets or when the case includes numerous materials for consideration, the court must set the time of holding the continuous hearing by an order.</p> <p>4. The court shall serve the summonses on the parties along with the order. When the hearing is scheduled for a continuous period, the summonses must also contain the days on which the hearing on examination of the proposal for confiscation resumes. The invitation must be sent eight (8) days before the beginning of the hearing.</p> <p>5. The provisions of the relevant law on contested procedure shall apply mutatis mutandis to the service of summonses.</p>	<p>2.1. dan, vreme i mesto održavanja rasprave;</p> <p>2.2. predlog za oduzimanje;</p> <p>2.3. lica koja će biti pozvana na raspravu;</p> <p>2.4.druga pitanja koja mogu biti od značaja za razmatranje predloga za oduzimanje.</p> <p>3. Ako predlog za oduzimanje sadrži veliku imovinsku masu ili ako predmet obuhvaća veliki broj materijala za razmatranje, sud mora naredbom odrediti vreme održavanja kontinuirane glavne rasprave.</p> <p>4. Uz naredbu sud šalje strankama i poziv za raspravu. Ako je zakazana kontinuirana glavna rasprava, poziv mora sadržati i dane u koje se nastavlja glavna rasprava o predlogu za oduzimanje. Poziv se mora poslati osam (8) dana pre početka rasprave.</p> <p>5. Za dostavljanje poziva shodno se primenjuju odredbe relevantnog zakona o parničnom postupku.</p>
---	---	--

<p>6. Në rast se kurdo gjatë procedurës së konfiskimit, pala në procedurë humbë zotësinë e veprimit ose vdes, Gjykata cakton një përfaqësuesi të përkohshëm të pasurisë së palës, sipas dispozitave të ligjit përkatës për procedurën kontestimore.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 34</b> <b>Publiciteti i shqyrtimit</b></p> <p>1. Seanca e shqyrtimit të propozimit për konfiskim është publike.</p> <p>2. Gjykata me vendim të arsyetuar, përjashton publikun nga seanca në rastet kur rrethanat të posaçme përfshijnë por nuk kufizohen në sigurinë kombëtare, jetën private, dhe kur këto rrethana janë më të rëndësishme sesa interesi publik.</p> <p>3. Me lejen e Gjykatës, në seancën jopublike mund të qëndrojnë në sallë personat zyrtarë të caktuar, punëtorët publikë dhe shkencorë, si dhe personat që merren me monitorimin e sistemit gjyqësor, po qe se një gjë e tillë është me interes për shërbimin e tyre, përkatësisht për veprimtarinë e tyre publike apo shkencore, me detyrimin që ta ruajnë si fshehtësi çdo gjë që mësojnë në seancë.</p>	<p>6. If at any time during the confiscation procedure, the party in the procedure loses the capacity to act or dies, the Court appoints a temporary representative of the party's asset, in accordance with the provisions of the relevant Law on Contested Procedure.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 34</b> <b>Trial publicity</b></p> <p>1. The hearing on examination of the proposal for confiscation shall be public.</p> <p>2. The court by a reasoned decision exempts the public from the hearing when exceptional circumstances, including but are not limited to, national security, private life, and where those circumstances outweigh the public interest.</p> <p>3. With the permission of the court, certain officers, public and scientific workers and persons dealing with the judicial system monitoring may stay in the courtroom, if it is in the interest for their service, namely for their activity, public or scientific, and the same shall be obliged to keep secret everything they become aware of in such a hearing, as well as the consequences for the disclosure of secrecy.</p>	<p>6. U slučaju da u bilo kom trenutku u toku postupka oduzimanja stranka u postupku izgubi poslovnu sposobnost ili umre, sud određuje privremenog zastupnika za imovinu stranke, u skladu sa odredbama relevantnog Zakona o parničnom postupku.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 34</b> <b>Javnost rasprave</b></p> <p>1. Glavna rasprava o predlogu za oduzimanje je javna.</p> <p>2. Sud obrazloženom odlukom isključuje javnost sa rasprave u slučajevima kada posebne okolnosti uključuju, ali se ne ograničavaju na nacionalnu bezbednost, privatni život, i kada su iste okolnosti važnije od javnog interesa.</p> <p>3. Uz dozvolu suda, glavnoj raspravi zatvorenoj za javnost mogu prisustvovati određena službena lica, javni i naučni radnici, kao i lica koja se bave praćenjem pravosudnog sistema, ako je to od interesa za njihovu službu, odnosno za njihovu javnu i naučnu delatnost, uz obavezu da sve što saznaju na glavnoj raspravi čuvaju u tajnosti.</p>
--	---	--

<p>4. Personat nga paragrafi 3 i këtij neni që nuk respektojnë detyrimin për ruajtje të fshehtësisë, mund të dënohen me dënim me gjobë në vlerë prej njëqind (100) euro deri në pesëqind (500) euro.</p> <p>5. Pala e dëmtuar mund të kërkojë kompensim në procedurën civile kontestimore, kur informatat nga seanca jopublike janë shfaqur në publik nga personat që kanë pasur detyrim të ruajnë fshehtësinë sipas paragrafit 3 të këtij neni.</p> <p>6. Çështjet tjera lidhur me publicitetin e shqyrtimit, të cilat nuk rregullohen me këtë ligj, rregullohen përshtatshëm me dispozitat e ligjit përkatës për procedurën kontestimore.</p>	<p>4. A fine of one hundred (100) Euro to five hundred (500) Euro may be imposed against the persons failing to comply with obligation for keeping the secret from paragraph 3 of this Article.</p> <p>5. The injured party may seek compensation in contested civil proceedings, when the issues in closed hearing have appeared in public by persons who have been obliged to abide by paragraph 3 of this Article.</p> <p>6. Other issues related to the trial publicity which are not regulated by this Law, shall be regulated in accordance with the provisions of the relevant law on contested procedure.</p>	<p>4. Lica iz stava 3. ovog člana koja ne poštuju obavezu čuvanja tajnosti mogu se kazniti novčanom kaznom u iznosu od sto (100) evra do petsto (500) evra.</p> <p>5. Oštećeni može tražiti naknadu u građanskom parničnom postupku, ako su lica, koja su inače bila dužna da čuvaju tajnost iz stava 3. ovog člana, u javnosti objavila informacije sa glavne rasprave zatvorene za javnost.</p> <p>6. Ostala pitanja u vezi sa javnošću glavne rasprave koja nisu uređena ovim zakonom shodno se uređuju odredbama relevantnog zakona o parničnom postupku.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 35</b> <b>Shqyrtimi në shkallën e parë</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 35</b> <b>Hearing in the first instance</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 35</b> <b>Rasprava u prvom stepenu</b></p>
<p>1. Sipas nenit 31 të këtij ligji, Byroja i paraqet provat para Gjykatës lidhur me përmbushjen e standardit civil të vlerësimit të gjasave, se pasuria që është objekt shqyrtimi është e pajustificueshme.</p> <p>2. Pas paraqitjes së propozimit në Gjykatë, pala në procedurë në seancën e shqyrtimit, duhet të provojë se pasuria që është objekt i</p>	<p>1. According to Article 31 of this Law, the Bureau presents the evidence before the Court regarding the fulfilment of the civil standard of assessing the balance of probabilities that the asset that is the subject of examination is unjustifiable.</p> <p>2. After submitting the proposal to the Court, the party to the procedure in the hearing session, must prove that the assets</p>	<p>1. Shodno članu 31. ovog zakona, Biro predočava sudu dokaze o ispunjenosti građanskog standarda procene verovatnoće da je imovina, koja je predmet rasprave, neopravdana.</p> <p>2. Nakon podnošenja predloga sudu, na glavnoj raspravi stranka u postupku mora dokazati da imovina koja je predmet</p>

<p>propozimi, ka prejardhje të justifikueshme ose të ofrojë dëshmi se nuk mund të sigurojë provat.</p> <p>3. Nëse pala në procedurë ofron dëshmi se nuk ka mundësi të sigurojë provat, atëherë pas kërkesës të cilësdo palë, Gjykata lëshon urdhër për sigurimin e provave.</p> <p>4. Në rast se pas zbatimit të urdhrit të Gjykatës, sipas paragrafit 3 të këtij neni, prova e cila është objekt i këtij urdhri nuk është e disponueshme ose nuk gjendet, konsiderohet se ka rrethana objektive që pamundësojnë palën në sigurimin e provave dhe si rrjedhojë Gjykata do të refuzojë propozimin për konfiskim si të pabazuar.</p> <p>5. Pas ofrimit të dëshmisë nga pala se prova nuk është e qasshme dhe nuk mund të sigurohet, dhe në rast se asnjëra palë nuk bën kërkesë Gjykatës për lëshimin e urdhrit për sigurimin e asaj prove, sipas paragrafit 3 të këtij neni, konsiderohet se ka rrethana objektive që pamundësojnë palën në sigurimin e provave dhe si rrjedhojë Gjykata do të refuzojë propozimin për konfiskim si të pabazuar.</p>	<p>subject to the proposal have a justifiable origin or provide evidence that they are unable to obtain the necessary evidence.</p> <p>3. If the party in the proceeding provides evidence that they are unable to obtain the evidence, then, upon the request of either party, the Court may issue an order to obtain the evidence.</p> <p>4. If, following the implementation of the Court's order, as per paragraph 3 of this Article, the evidence that is the subject of this order is unavailable or cannot be found, it is considered that objective circumstances prevent the party from obtaining the evidence, and as a result, the Court will reject the proposal for confiscation as unfounded.</p> <p>5. After the party provides evidence that the evidence is inaccessible and cannot be obtained, and if neither party requests the Court to issue an order to obtain that evidence, as per paragraph 3 of this Article, it is considered that objective circumstances prevent the party from obtaining the evidence, and as a result, the Court will reject the proposal for confiscation as unfounded.</p>	<p>predloga ima opravdano poreklo, ili pružiti dokaze da ne može da obezbedi dokaze.</p> <p>3. Ako stranka u postupku pruži dokaz da nije u mogućnosti da obezbedi dokaze, onda na zahtev bilo koje stranke sud izdaje nalog za obezbeđenje dokaza.</p> <p>4. U slučaju da nakon izvršenja naloga Suda, prema stavu 3. ovog člana, dokaz koji je predmet ovog naloga nije dostupan ili nije pronađen, smatra se da postoje objektivne okolnosti koje sprečavaju stranku da obezbedi dokaze pa će shodno tome sud odbiti predlog za oduzimanje kao neosnovanim.</p> <p>5. Nakon pružanja dokaza stranke da dokaz nije dostupan i da se ne može obezbediti, i u slučaju da nijedna strana ne podnese zahtev Sudu za izdavanje naloga za obezbeđenje tog dokaza, shodno stavu 3. ovog člana, smatra se da postoje objektivne okolnosti koje sprečavaju stranku da obezbedi dokaze pa će shodno tome sud odbiti predlog za oduzimanje kao neosnovanim.</p>
---	--	--

<p align="center"><b>Neni 36</b> <b>Seanca e shqyrtimit</b></p>	<p align="center"><b>Article 36</b> <b>Hearing session</b></p>	<p align="center"><b>Član 36</b> <b>Glavna rasprava</b></p>
<p>1. Gjyqtari, në seancën e shqyrtimit fillimisht konstaton se palët janë ftuar në mënyrë të rregullt, prezencën e palëve në seancë dhe merr aktvendim me të cilin konstaton nëse janë plotësuar kushtet për mbajtjen e seancës për shqyrtim të propozimit për konfiskim.</p> <p>2. Kur zyrtari i Byrosë nuk paraqitet në seancën e shqyrtimit edhe pse është thirrur rregullisht, ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar në asnjë mënyrë, konsiderohet se e ka tërhequr propozimin për konfiskim.</p> <p>3. Po qe se në seancë e shqyrtimit nuk paraqitet personi pasuria e të cilit propozohet për konfiskim edhe pse është thirrur rregullisht, atëherë seanca e shqyrtimi mbahet pa praninë e tij.</p> <p>4. Në rast se konstatohet se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e seancës sipas paragrafit 1 të këtij neni, gjyqtari bën hapjen e shqyrtimit, duke konstatuar:</p> <p>4.1. propozimin për konfiskim;</p>	<p>1. The presiding judge shall, in the hearing, initially ascertain that the parties have been duly summoned, then ascertain the presence of the parties in the hearing, and make a ruling by which he/she ascertains whether the conditions for holding the hearing on examination of the proposal for confiscation are met.</p> <p>2. When a Bureau officer fails to appear at the hearing even though he/she has been duly summoned, and he/she has not justified the absence in any way, he/she shall be considered to have withdrawn the proposal for confiscation.</p> <p>3. If the person whose assets are proposed for confiscation fails not appear at the hearing, even though it has been duly summoned, the hearing shall be held without his/her presence.</p> <p>4. In case it is found that the conditions for holding the hearing under paragraph 1 of this Article are met, the judge shall open the hearing, stating:</p> <p>4.1. the proposal for confiscation;</p>	<p>1. Na glavnoj raspravi sudija prvo utvrđuje da su stranke uredno pozvane, prisustvo stranaka na ročištu i donosi rešenje kojim utvrđuje da li su ispunjeni uslovi za održavanje glavne rasprave o predlogu za oduzimanje.</p> <p>2. Ako se uredno pozvani službenik Biroa ne pojavi na glavnoj raspravi, a izostanak ni na koji način ne opravda, smatra se da je povukao predlog za oduzimanje.</p> <p>3. Ako se uredno pozvano lice čija se imovina predlaže za oduzimanje ne pojavi na glavnoj raspravi, glavna raspravu održava se bez njegovog prisustva.</p> <p>4. Ako se utvrdi da su ispunjeni uslovi za održavanje rasprave iz stava 1. ovog člana, sudija otvara glavnu raspravu utvrđivanjem:</p> <p>4.1. predloga za oduzimanje;</p>

<p>4.2. llojin e pasurisë që propozohet për konfiskim;</p> <p>4.3. numrin dhe datën e propozimit;</p> <p>4.4. zyrtarin e Byrosë;</p> <p>4.5. personin, pasuria e së cilit propozohet të konfiskohet dhe përfaqësuesin e tij, nëse ka;</p> <p>4.6. palën e tretë dhe përfaqësuesin e tij, nëse ka.</p> <p>5. Gjyqtari njofton palët me emrin e tij dhe iu kërkon atyre që të deklarohen në rast të vërejtjeve apo kërkesave për përjashtim të gjyqtarit. Dispozitat e ligjit përkatës për procedurën kontestimore zbatohen përshtatshëm për përjashtimin e gjyqtarëve.</p> <p>6. Pas hapjes së seancës për shqyrtimin e propozimit për konfiskim, gjyqtari, i kalon fjalën zyrtarit të Byrosë, i cili lexon propozimin për konfiskim dhe argumenton se si ka rezultuar sipas Byrosë që pasuria është e pajustificueshme.</p> <p>7. Pas leximit dhe argumentimit të propozimit, fjala i kalon personit, pasuria e së cilit propozohet të konfiskohet apo</p>	<p>4.2.the type of assets proposed for confiscation;</p> <p>4.3. the number and date of the proposal;</p> <p>4.4. the Bureau officer;</p> <p>4.5. the person whose assets are proposed to be confiscated and his/her representative, if any;</p> <p>4.6. the third party and his/her representative, if any.</p> <p>5. The judge shall inform the parties of his/her name and shall ask them to declare in case of remarks or requests for disqualification of the judge. The provisions of the relevant Law on Contested Procedure shall apply mutatis mutandis to the disqualification of judges.</p> <p>6. After the opening of the hearing on examination of the proposal for confiscation, the judge shall pass the floor to the Bureau representative, who shall read the proposal for confiscation and shall argue as to how it has resulted according to the Bureau that the assets are unjustifiable.</p> <p>7. After reading and providing arguments for the proposal, the floor is given to the party or the defense counsel for the party,</p>	<p>4.2. vrste imovine koja se predlaže za oduzimanje;</p> <p>4.3. broja i datuma predloga;</p> <p>4.4. službenika Biroa;</p> <p>4.5. lica čija se imovina predlaže za oduzimanje i njegovog zastupnika, ako ga ima;</p> <p>4.6. trećeg lica i njegovog zastupnika, ako ga ima.</p> <p>5. Sudija se predstavlja strankama i od njih traži da se izjasne ako imaju primedbe ili zahteve za izuzeće sudije. Odredbe relevantnog zakona o parničnom postupku shodno se primenjuju na izuzeće sudija.</p> <p>6. Po otvaranju glavne rasprave o predlogu za oduzimanje, sudija daje reč službeniku Biroa, koji čita predlog za oduzimanje i obrazlaže mišljenje Biroa da je imovina neopravdana.</p> <p>7. Nakon čitanja i obrazlaganja, sud daje reč licu čija se imovina predlaže za oduzimanje ili njegovom zastupniku da se izjasni o</p>
--	--	---



<p>përfaqësuesit të tij, për t'u deklaruar lidhur me propozimin për konfiskim të pasurisë. Personi, pasuria e së cilit propozohet të konfiskohet apo përfaqësuesi i tij, kanë të drejtë që të paraqesin prova që dëshmojnë se pasuria është e justifikueshme.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 37</b> <b>Administrimi i provave</b></p> <p>1. Pasi që palët të kenë dhënë argumentet e tyre, Gjykata kalon në administrimin e provave.</p> <p>2. Fillimisht administrohen provat e propozuara nga Byroja, ndërsa personi, pasuria e së cilit propozohet të konfiskohet apo përfaqësuesi i tij, kanë të drejtë që të kundërshtojë çdo provë që administrohet, sa i përket:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. vërtetësisë së provës;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. pranueshmërisë së provës; apo</p> <p style="padding-left: 20px;">2.3. besueshmërisë së provës.</p> <p>3. Pas administrimit të provave që mbështesin propozimin për konfiskim, Gjykata vazhdon me administrimin e provave që paraqiten nga personi, pasuria e së cilit propozohet të konfiskohet apo përfaqësuesi i tij. Pala tjetër mund të</p>	<p>to plead regarding the proposal for confiscation of assets. The party or defense counsel shall have the right to present evidence proving that the assets are justifiable.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 37</b> <b>Evidentiary proceedings</b></p> <p>1. Once the parties have given their arguments, the court shall proceed with the evidentiary proceedings.</p> <p>2. The evidence proposed by Bureau shall be initially processed, where the person whose assets are proposed to be confiscated or his/her representative shall have the right to challenge any evidence processed, regarding:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. the authenticity of the evidence;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. the admissibility of the evidence; or</p> <p style="padding-left: 20px;">2.3. reliability of the evidence.</p> <p>3. After processing the evidence supporting the proposal for confiscation, the court shall proceed with the administration of the evidence presented by the person whose assets are proposed to be confiscated or his/her representative. The other party may oppose any evidence</p>	<p>predlogu za oduzimanje imovine. Lice čija se imovina predlaže za oduzimanje ili njegov zastupnik imaju pravo da iznesu dokaze koji dokazuju da je imovina opravdana.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 37</b> <b>Izvođenje dokaza</b></p> <p>1. Nakon što stranke iznesu svoje argumente, sud prelazi na izvođenje dokaza.</p> <p>2. Prvo se izvode dokazi koje predlaže Biro, dok lice čija se imovina predlaže za oduzimanje ili njegov zastupnik imaju pravo da ulože prigovor na svaki dokaz koji se izvodi u pogledu:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. istinitosti dokaza;</p> <p style="padding-left: 20px;">2.2. prihvatljivosti dokaza; ili</p> <p style="padding-left: 20px;">2.3. verodostojnosti dokaza.</p> <p>3. Nakon izvođenja dokaza koji potkrepljuju predlog za oduzimanje, sud nastavlja sa izvođenjem dokaza lica čija se imovina predlaže za oduzimanje ili njegovog zastupnika. Druga strana može osporiti bilo koji dokaz iz stava 2. ovog člana.</p>
--	--	---

<p>kundërshtoj çdo provë përshtatshëmrisht sikurse në paragrafin 2 të këtij neni.</p> <p>4. Në seancën e shqyrtimit palët mund të propozojnë marrjen në pyetje të dëshmitarëve për rrethana të caktuara që ndërlidhen me pasurinë që i nënshtrohet propozimit për konfiskim.</p> <p>5. Para fillimit të marrjes në pyetje të dëshmitarit, Gjykata e njofton dëshmitarin për detyrimet e tij si vijon:</p> <p>5.1. se është i obliguar që të deklarojë të vërtetën;</p> <p>5.2. nuk i lejohet të heshtë kur ka dijeni për çështjen për të cilën i kërkohet të dëshmojë; dhe</p> <p>5.3. në rast se nuk e deklaron të vërtetën ai mund të përgjigjet penalisht për deklarim të rremë.</p> <p>6. Fillimisht, pala që ka propozuar dëgjimin e dëshmitarit parashtron pyetje dhe kërkon sqarime nga dëshmitari, dhe më pas pala tjetër shtron pyetje dhe kërkon sqarime nga dëshmitari. Kur palët deklarojnë se nuk kanë pyetje tjera ndaj dëshmitarit, gjyqtari mund</p>	<p>accordingly as in paragraph 2 of this Article.</p> <p>4. At the hearing, the parties may propose the examination of witnesses for certain circumstances related to the assets subject to the proposal for confiscation.</p> <p>5. Before the commencement of the witness examination, the court shall notify the witness of his/her obligations as follows:</p> <p>5.1. that he/she is obliged to tell the truth;</p> <p>5.2. he/she is not allowed to keep silent when he/she has knowledge of the matter for which he/she is required to testify; and</p> <p>5.3. if he/she does not tell the truth he/she can be held criminally liable for false statements.</p> <p>6. Initially, the party proposing to hear the witness shall ask questions and seek clarification from the witness, and then the other party shall ask questions and seek clarification from the witness. When the parties state that they have no further questions for the witness, the presiding</p>	<p>4. Na glavnoj raspravi stranke mogu predložiti saslušavanje svedoka o određenim okolnostima u vezi sa imovinom koja je predmet predloga za oduzimanje.</p> <p>5. Pre početka saslušavanja svedoka, sud obaveštava svedoka o njegovim dužnostima, i to:</p> <p>5.1. da je dužan da govori istinu;</p> <p>5.2. da ništa od onoga što mu je poznato o stvari za koju je pozvan da svedoči ne sme da prećuti; i</p> <p>5.3. da ako ne govori istinu može krivično odgovarati za lažni iskaz.</p> <p>6. Na početku stranka koja je predložila saslušavanje svedoka postavlja pitanja i od svedoka traži pojašnjenja, a zatim druga strana postavlja pitanja i od svedoka traži pojašnjenja. Kada stranke izjave da nemaju više pitanja za svedoka, sudija može</p>
--	---	--

<p>të parashtrojë pyetje dhe të kërkojë sqarime ndaj dëshmitarit.</p> <p>7. Dëshmitari mund të thirret në të drejtën e tij për të refuzuar dhënien e dëshmisë në përputhje me ligjin përkatës për procedurën kontestimore.</p> <p>8. Secila palë ka të drejtë që të propozojë në Gjykatë marrjen e çfarëdo prove që ndërlidhet me pasurinë që i nënshtrohet propozimit për konfiskim, përfshirë marrjen e provave brenda apo jashtë vendit.</p> <p>9. Gjykata mund të refuzojë propozimin për marrjen e një prove, vetëm kur prova e tillë nuk ka të bëjë me pasurinë që i nënshtrohet propozimit.</p> <p>10. Dispozitat e ligjit përkatës për procedurën kontestimore zbatohen përshtatshmërisht lidhur me administrimin e provave.</p>	<p>judge may ask questions and seek clarification from the witness.</p> <p>7. The witness may invoke his/her right to reject to testify in accordance with the relevant law on contested procedure.</p> <p>8. Each party shall have the right to propose to the court the taking any evidence related to the assets subject to the proposal for confiscation, including the taking of evidence inside or outside the country.</p> <p>9. The court may reject the proposal to obtain evidence only when such evidence does not relate to the assets subject to the proposal.</p> <p>10. The provisions of the relevant law on the contested procedure shall be accordingly applied to the administration of evidence.</p>	<p>postavljati pitanja i od svedoka tražiti pojašnjenja.</p> <p>7. Svedok se može pozvati na svoje pravo da uskrati svedočenje u skladu sa relevantnim zakonom o parničnom postupku.</p> <p>8. Svaka stranka ima pravo da predloži sudu pribavljanje bilo kog dokaza u vezi sa imovinom koja je predmet predloga za oduzimanje, uključujući i pribavljanje dokaza unutar ili van zemlje.</p> <p>9. Sud može odbiti predlog za pribavljanje dokaza samo ako se takav dokaz ne odnosi na imovinu koja je predmet predloga.</p> <p>10 Odredbe relevantnog zakona o parničnom postupku shodno se primenjuju na izvođenje dokaza.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 38</b> <b>Marrja në pyetje e palës, pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 38</b> <b>Examination of the party whose assets are proposed to be confiscated</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 38</b> <b>Saslušavanje stranke čija se imovina predlaže za oduzimanje</b></p>
<p>1.Kur Gjykata konstaton se janë administruar të gjitha provat dhe janë dëgjuar dëshmitarët sipas nenit 37 të këtij</p>	<p>1. When the court finds that the evidentiary proceedings has been completed and the witnesses have been heard under Article 37</p>	<p>1. Kada sud utvrdi da su izvedeni svi dokazi i da su svedoci saslušani u skladu sa članom 37. ovog zakona, onda sud poziva na</p>

<p>ligji, atëherë Gjykata e fton palën, pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet, që të merret në pyetje.</p> <p>2. Pala, pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet, ka të drejtë që të mos përgjigjet në pyetjet e parashtruara. Nëse zgjedh që të përgjigjet në pyetje, atëherë ai mund të jap dëshminë e tij për pasurinë që është objekt i shqyrtimit të propozimit për konfiskim.</p> <p>3. Ndaj palës, pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet, fillimisht, parashtron pyetje përfaqësuesi i tij dhe kërkon sqarime për pasurinë që është objekt i propozimit për konfiskim.</p> <p>4. Pas marrjes në pyetje të palës, pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet, nga ana e përfaqësuesit të tij, atë e merr në pyetje zyrtari i Byrosë për të kërkuar sqarime për pasurinë që është objekt i propozimit për konfiskim.</p> <p>5. Pas marrjes në pyetje nga zyrtari i Byrosë, pyetje mund të parashtrë pala e tretë, që kërkon sqarime nga pala, pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet, për pasurinë që është objekt i propozimit për konfiskim.</p>	<p>of this Law, the Court shall summon the party whose assets are proposed to be confiscated to be examined.</p> <p>2. The party, whose assets are proposed to be confiscated, shall have the right not to answer the questions posed. If he/she chooses to answer the questions, then he/she may give his/her testimony about the assets subject of the hearing on the proposal for confiscation.</p> <p>3. Firstly, the party whose assets are proposed to be confiscated shall be asked questions and sought clarification on the assets subject of the proposal for confiscation by his/her representative.</p> <p>4. After examining the party whose assets are proposed to be confiscated by the defense counsel, such party shall be examined by the Bureau representative seeking clarification on the assets subject of the proposal for confiscation.</p> <p>5. After examination by the Bureau representative, questions may be asked by the third party, seeking clarifications from the party whose assets are proposed to be confiscated, for the assets subject of the proposal for confiscation.</p>	<p>saslušanje stranku čija se imovina predlaže za oduzimanje.</p> <p>2. Stranka čija se imovina predlaže za oduzimanje ima pravo da ne odgovara na postavljena pitanja. Ako odluči da odgovara na pitanja, onda može dati svoj iskaz o imovini koja je predmet razmatranja predloga za oduzimanje.</p> <p>3. Stranci, čija se imovina predlaže za oduzimanje, prvo postavlja pitanja njen zastupnik i traži pojašnjenja o imovini koja je predmet predloga za oduzimanje.</p> <p>4. Nakon što stranku čija je imovina predložena za oduzimanje saslušava njen zastupnik, stranku saslušava službenik Biroa tražeći pojašnjenja o imovini koja je predmet predloga za oduzimanje.</p> <p>5. Nakon što službenik Biroa saslušava stranku, pitanja može postaviti i treće lice, tražeći pojašnjenja od stranke, čija se imovina predlaže za oduzimanje, o imovinu koja je predmet predloga za oduzimanje.</p>
--	--	--

<p>6. Gjykata pastaj pyet përfaqësuesin e personit, pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet, zyrtarin e Byrosë apo palën e tretë, nëse kanë pyetje shtesë ndaj personit, pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet. Kur gjykata konstaton se nuk ka pyetje shtesë, atëherë gjyqtari mund të parashtrojë pyetje për të sqaruar çdo rrethanë që lidhet me pasurinë që është objekt i propozimit për konfiskim.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 39</b> <b>Deklarimi përfundimtar</b></p> <p>1. Pas marrjes në pyetje të personit, pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet, Gjykata kalon në dëgjimin e deklarimit përfundimtar të palëve, në renditjen si vijon:</p> <p>1.1. Fillimisht deklarimi përfundimtar jepet nga zyrtari i Byrosë, i cili argumenton se sipas vlerësimit të gjasave, pasuria ka prejardhje të pajustificueshme dhe duhet të konfiskohet;</p> <p>1.2. Deklarimin përfundimtar e jep më pas përfaqësuesi i personit, pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet, i cili argumenton se propozimi për konfiskim është i papabazuar;</p>	<p>6. The court shall then ask the representative of the person whose assets are proposed to be confiscated, the Bureau representative or the third party if they have additional questions to the party whose assets are proposed to be confiscated. When the court finds that there are no additional questions, the judge may ask questions to clarify any circumstances related to the assets subject of the proposal for confiscation.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 39</b> <b>Closing statement</b></p> <p>1. After examining the party whose assets are proposed to be confiscated, the court shall proceed with the closing statements of the parties, in the following order:</p> <p>1.1. initially, the closing statement shall be given by the Bureau officer, who argues that according to the balance of probabilities, the assets should be confiscated;</p> <p>1.2. the closing statement shall then be given by the representative of the person whose assets are proposed to be confiscated, who argues that the proposal for confiscation is unfounded;</p>	<p>6. Sud zatim pita zastupnika lica čija se imovina predlaže za oduzimanje, službenika Biroa ili treće lica da li imaju dodatna pitanja za lica čija se imovina predlaže za oduzimanje. Kada sud utvrdi da nema dodatnih pitanja, onda sudija može postavljati pitanja radi pojašnjenja svake okolnosti u vezi sa imovinom koja je predmet predloga za oduzimanje.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 39</b> <b>Završna reč</b></p> <p>1. Nakon saslušanja lica čija se imovina predlaže za oduzimanje, sud prelazi na završne reči stranaka, i to po sledećem redosledu:</p> <p>1.1. završnu reč prvo iznosi službenik Biroa, koji obrazlaže da prema proceni verovatnoće imovina ima neopravdano poreklo i da se treba oduzeti;</p> <p>1.2. zatim završnu reč iznosi zastupnik lica čija se imovina predlaže za oduzimanje, koji obrazlaže da je predlog za oduzimanje neosnovan;</p>
--	---	--

<p>1.3. Deklarimin përfundimtar e jep më pas pala e tretë nëse ka të tillë, e cila argumenton se ka ardhur në posedim ose pronësi të pasurisë që propozohet të konfiskohet me mirëbesim dhe se kjo është vërtetuar në seancën e shqyrtimit.</p> <p>1.4. Pastaj, deklarin përfundimtar e jep personi, pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet, i cili argumenton se pasuria është justifikuar dhe se e njëjta nuk ka bazë që të konfiskohet;</p> <p>2. Në deklarin përfundimtar, palët mund t'i referohen aspekteve ligjore, provave që janë shqyrtuar në gjykatë dhe rrethanave të tjera që vërtetojnë pajustificueshmërinë apo justifikueshmërinë e pasurisë.</p> <p>3. Në deklarin përfundimtar, palët mund t'u referohen provave të administruara në shqyrtim gjatë procedurës gjyqësore.</p>	<p>1.3. the closing statement shall then be given by the third party, if any, who argues that he/she has come into possession or ownership of the assets that are proposed to be confiscated in good faith and that this has been verified at the hearing;</p> <p>1.4. then, the closing statement shall be given by the person whose assets are proposed to be confiscated, who argues that the assets are justified and that the same has no grounds to be confiscated;</p> <p>2. In the closing statements, the parties may refer to the legal aspects, the evidence that has been examined in court and other circumstances proving the unjustifiability or justifiability of the assets.</p> <p>3. In the closing statements, the parties may refer to the evidence administered during the trial proceedings.</p>	<p>1.3. zatim završnu reč iznosi treće lice, ako postoji, koje obrazlaže da je savesno ušlo u državinu ili vlasništvo imovine koja se predlaže za oduzimanje, te da je to dokazano na glavnoj raspravi;</p> <p>1.4. zatim završnu reč iznosi lice čija se imovina predlaže za oduzimanje, koje obrazlaže da je imovina opravdana i da ne postoji osnovi za njeno oduzimanje.</p> <p>2. U završnoj reči stranke se mogu pozivati na pravne aspekte, dokaze koji su razmotreni pred sudom i druge okolnosti koje dokazuju neopravdanost ili opravdanost imovine.</p> <p>3. U završnoj reči stranke se mogu pozvati na dokaze koji su u toku sudskog postupka izvedeni na glavnoj raspravi.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 40</b> <b>Tërheqja nga propozimi</b></p> <p>1. Byroja ka të drejtë që deri në përfundimin e seancës për shqyrtim të tërhiqet nga propozimi për konfiskimin e pasurisë.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 40</b> <b>Withdrawal from the proposal</b></p> <p>1. The Bureau shall have the right to withdraw from the proposal for confiscation of assets until the end of the hearing.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 40</b> <b>Povlačenje predloga</b></p> <p>1. Biro ima pravo da do završetka glavne rasprave povuče predlog za oduzimanje imovine.</p>

<p>2. Byroja me rastin e tërheqjes nga propozimi, arsyeton para gjykatës shkaqet e tërheqjes.</p> <p>3. Gjykata në rast të tërheqjes nga propozimi, menjëherë nxjerr aktvendim të arsyetuar në procesverbal, konstaton tërheqjen e propozimit dhe përfundimin e procedurës. Aktvendimi u dërgohet palëve.</p> <p>4. Në rast të tërheqjes nga propozimi, rasti konsiderohet si çështje e gjykuar.</p>	<p>2. When withdrawing from the proposal, the Bureau shall justify before the court the reasons for such withdrawal.</p> <p>3. In case of withdrawal from the proposal, the court shall promptly issue a reasoned ruling in the minutes, it shall ascertain the withdrawal of the proposal and the completion of the proceedings. The ruling shall be serve on the parties.</p> <p>4. In case of withdrawal from the proposal, the case shall be considered as an adjudicated case.</p>	<p>2. U slučaju povlačenja predloga, Biro pred sudom obrazlaže razloge za povlačenje.</p> <p>3. U slučaju povlačenja predloga, sud odmah donosi obrazloženo rešenje za zapisnik, utvrđuje povlačenje predloga i okončanje postupka. Rešenje se dostavlja strankama.</p> <p>4. U slučaju povlačenja predloga, predmet se smatra presuđenom stvari.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 41</b> <b>Përfundimi i shqyrtimit dhe vendosja</b></p> <p>1. Pas dhënies së deklaramit përfundimtar të palëve, gjykata kujdeset nëse ka nevojë të rihap shqyrtimin për shkak të ndonjë rrethane. Kur gjykata konstaton se nuk ka nevojë për rihapje të shqyrtimit, konstaton se seanca e shqyrtimit të propozimit për konfiskim ka përfunduar.</p> <p>2. Pas përfundimit të seancës së shqyrtimit të propozimit për konfiskim, gjykata tërhiqet për të vendosur lidhur me propozimin për konfiskim.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 41</b> <b>Conclusion of the hearing and decision making</b></p> <p>1. After giving the closing statements by the parties, the court shall consider whether it needs to reopen the hearing due to any circumstances. When the court finds that there is no need to reopen the hearing, it shall find that the hearing on the proposal for confiscation is concluded.</p> <p>2. After the conclusion of the hearing on the proposal for confiscation, the court shall recess for deliberation regarding the proposal for confiscation.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 41</b> <b>Završetak glavne rasprave i odlučivanje</b></p> <p>1. Nakon završnih reči stranaka, sud se stara o tome da li zbog određene okolnosti postoji potreba za ponovnim otvaranjem glavne rasprave. Kada sud utvrdi da nema potrebe za ponovnim otvaranjem glavne rasprave, utvrđuje da je glavna rasprava po predlogu za oduzimanje završena.</p> <p>2. Po završetku glavne rasprave o predlogu za oduzimanje, sud se povlači da odlučuje o predlogu za oduzimanje.</p>

<p>3. Gjykata me rastin e vendosjes mban procesverbal në të cilin konstaton:</p> <p>3.1. nëse personi, pasuria e të cilit propozohet të konfiskohet, ka arritur të provojë se pasuria ka prejardhje të justifikueshme;</p> <p>3.2. se ka vendosur që të refuzojë propozimin për konfiskim si të pabazuar; ose</p> <p>3.3. se ka vendosur të konfiskojë pasurinë, prejardhja e justifikueshme e së cilës nuk është provuar, duke specifikuar llojin dhe natyrën e pasurisë së pajustificuar.</p>	<p>3. The court shall keep minutes in the course of rendering a decision on:</p> <p>3.1. finding whether the person whose assets are proposed to be confiscated, has succeeded in proving that the assets are justified;</p> <p>3.2. deciding to reject the proposal for confiscation as unfounded; or</p> <p>3.3. deciding to confiscate the assets, the unjustifiable origin of which has not been proven, specifying the type and nature of the unjustifiable assets.</p>	<p>3. Prilikom odlučivanja sud vodi zapisnik u kome navodi:</p> <p>3.1. da li je lice, čija je imovina predložena za oduzimanje, uspeo da dokaže da imovina ima opravdano poreklo;</p> <p>3.2. da je odlučio da odbije predlog za oduzimanje kao neosnovan; ili</p> <p>3.3. da je odlučio da oduzme imovinu, čija opravdano poreklo nije dokazano, navodeći vrstu i prirodu neopravdane imovine.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 42</b> <b>Llojet e vendimeve</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 42</b> <b>Types of decisions</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 42</b> <b>Vrste odluka</b></p>
<p>1. Gjykata vendosë me aktgjykim lidhur me propozimin për konfiskimin e pasurisë. Për të gjitha çështjet tjera gjykata vendos me anë të aktvendimit.</p> <p>2. Kur gjykata, sipas vlerësimit të gjasave, vlerëson se propozimi për konfiskimin e pasurisë është i bazuar dhe se pasuria është e pajustificueshme, ajo me aktgjykim konstaton se pasuria nuk justifikohet dhe urdhëron konfiskimin e saj.</p> <p>3. Kur gjykata, sipas vlerësimit të gjasave, vlerëson se propozimi për konfiskimin e pasurisë është pjesërisht i bazuar, ajo me</p>	<p>1. The court shall render a judgment on the proposal for confiscation of assets. The court shall decide on all cases by ruling.</p> <p>2. When the court, according to the balance of probabilities, finds that the proposal for confiscation of assets is founded and that the assets are unjustifiable, it shall render a judgment finding that the assets are not justified and shall order confiscation.</p> <p>3. When the court, according to the balance of probabilities, finds that the proposal for confiscation of assets is partially founded,</p>	<p>1. O predlogu za oduzimanje imovine sud odlučuje presudom. O svim ostalim pitanjima sud odlučuje rešenjem.</p> <p>2. sud, prema proceni verovatnoće, oceni da je predlog za oduzimanje imovine osnovan i da je imovina neopravdana, presudom utvrđuje da imovina nije opravdana i nalaže njeno oduzimanje.</p> <p>3. Kada sud, prema proceni verovatnoće, oceni da je predlog za oduzimanje imovine delimično osnovan, presudom delimično</p>



<p>aktgjykim miraton pjesërisht propozimin, konstaton se ajo pjesë e pasurisë nuk justifikohet dhe urdhëron konfiskimin e saj. Për pjesën tjetër të pasurisë e refuzon propozimin si të pabazuar dhe konstaton se ajo pjesë e pasurisë është e justifikueshme.</p> <p>4. Kur gjykata, sipas vlerësimit të gjasave, vlerëson se propozimi për konfiskimin e pasurisë është i pabazuar, ajo me aktgjykim refuzon propozimin për konfiskim dhe konstaton se pasuria është e justifikueshme.</p> <p>5. Kur Gjykata konstaton se propozimi për konfiskim është i pa afatshëm, gjykata hedhë poshtë propozimin si të palejuar.</p> <p>6. Shkaqet e refuzimit të propozimit për konfiskim përfshijnë por pa u kufizuar në:</p> <p>6.1. propozimi për konfiskim përfshinë pasurinë verifikimi i së cilës nuk lejohet sipas ligjit;</p> <p>6.2. propozimin të parashtruar pas kalimit të afatit ligjor, kur me dispozita është paraparë afati ligjor.</p>	<p>it shall partially grant the proposal by a judgment, finding that a part of the assets is not justified and shall order its confiscation, and it shall reject the proposal as unfounded for the rest of the assets and shall find the assets justified. For the rest of assets, it rejects the proposal as unfounded and finds that that part of assets is justifiable.</p> <p>4. When the court, according to the balance of probabilities, finds that the proposal for confiscation of assets is not founded, it shall reject the proposal for confiscation by a judgment and shall find that the assets are justified.</p> <p>5. When the Court finds that the proposal for confiscation is belated, the court shall dismiss the proposal as inadmissible.</p> <p>6. Reasons for rejecting the proposal for confiscation include but are not limited to:</p> <p>6.1. the proposal for confiscation includes the assets whose verification is not allowed by law;</p> <p>6.2. the proposal was submitted after the expiration of the legal deadline, when the provisions provide for the legal deadline.</p>	<p>usvaja predlog, utvrđuje da taj deo imovine nije opravdan i nalaže njegovo oduzimanje. Za preostali deo imovine predlog odbija kao neosnovan i utvrđuje da je taj deo imovine opravdan.</p> <p>4. Kada sud, prema proceni verovatnoće, oceni da je predlog za oduzimanje imovine neosnovan, presudom odbija predlog za oduzimanje i utvrđuje da je imovina opravdana.</p> <p>5. Kada sud utvrdi da je predlog za oduzimanje neblagovremen, sud odbacuje predlog kao nedozvoljen.</p> <p>6. Razlozi za odbijanje predloga za oduzimanje uključuju, ali nisu ograničeni na:</p> <p>6.1. predlog za oduzimanje obuhvata imovinu čija provera zakonom nije dozvoljena;</p> <p>6.2. predlog podnet po isteku zakonskog roka, kada je zakonski rok predviđen odredbama;</p>
--	---	--

<p>6.3. pasuria nuk tejkalon vlerën e përcaktuar sipas nenit 24, paragrafi 8 dhe 9 të këtij ligji;</p> <p>6.4. provat qe janë shqyrtuar në seancën e shqyrtimit, justifikojnë prejardhjen e pasurisë;</p> <p>6.5. provat qe janë shqyrtuar në seancën e shqyrtimit, provojnë se pasuria është fituar me mirëbesim nga pala e tretë;</p> <p>6.6. pasuria e pajustificueshme për konfiskim do të përfshijë pasurinë që është në pronësi, posedim, apo mbi të cilën pala në procedurë ushtron formë tjetër të kontrollit, apo nga e cila pala në procedurë ka ndonjë dobi.</p> <p>6.7. propozim për konfiskim do të përfshijë pasurinë e cila nuk ka qenë në pronësi, posedim apo në formë tjetër të kontrollit nga pala në procedurë.</p>	<p>6.3. the assets that do not exceed the value determined under Article 24, paragraphs 8 and 9 of this Law;</p> <p>6.4. the evidence examined at the hearing justifies the origin of the assets;</p> <p>6.5. the evidence was examined at the hearing prove that the assets were acquired in good faith by a third party;</p> <p>6.6. unjustifiable assets for confiscation shall include assets owned, possessed, or over which the party to the procedure exercises another form of control, or from which the party to the procedure has any benefit.</p> <p>6.7. the assets specified in the proposal for confiscation was not owned, possessed or otherwise controlled by the party to the procedure.</p>	<p>6.3. imovina ne prelazi vrednost iz člana 24. st. 8. i 9. ovog zakona;</p> <p>6.4. dokazi koji su razmotreni na glavnoj raspravi opravdavaju poreklo imovine;</p> <p>6.5. dokazi koji su razmotreni na glavnoj raspravi potvrđuju da je treće lice savesno steklo imovinu;</p> <p>6.6. neopravdana imovina za oduzimanje obuhvata imovinu koja se nalazi u vlasništvu, državini ili nad kojom stranka u postupku vrši drugi oblik kontrole ili od koje stranka u postupku ima bilo kakvu korist.</p> <p>6.7. predlog za oduzimanje obuhvata imovinu koja nije bila u vlasništvu, državini ili bilo kakvom obliku kontrole od strane stranke u postupku.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 43</b> <b>Pasuritë zëvendësuese</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 43</b> <b>Substitutive assets</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 43</b> <b>Zamenska imovina</b></p>
<p>1. Kur nuk është e mundur të konfiskohet pasuria e propozuar për konfiskim, atëherë do të konfiskohet vlera zëvendësuese, sipas vlerës së pasurisë në treg në kohën e vendimit nga Gjykata.</p>	<p>1. When it is not possible to confiscate the proposed assets for confiscation, then the replacement value will be confiscated, according to the market value of the asset at the time of the decision by the Court.</p>	<p>1. Kada nije moguće oduzeti imovinu predloženu za oduzimanje, u tom slučaju oduzima se zamenska vrednost, prema vrednosti imovine na tržištu u vreme donošenja odluke suda.</p>

<p>2.Çdo transaksion i kryer në pasuri të fituara në mënyrë të pajustificueshme nuk do të kenë efekt në lidhje me Shtetin dhe çdo transaksion i tillë do të konfiskohet, kur është transaksion me barrë me palët e treta, nëse palët në fjalë e dinin ose mund të kishin supozuar se pasuria ishte blerë në mënyrë të paligjshme ose nëse palët në fjalë e kanë blerë pasurinë me qëllim të fshehjes së burimit të pajustificueshme të tyre ose të drejtave aktuale të lidhura me ta.</p> <p>3. Konfiskimi zbatohet gjithashtu ndaj çdo pasurie që është bartur tek një palë e tretë për llogari të personit që është nën shqyrtim për të shmangur konfiskimin e pasurisë në fjalë ose për të fshehur burimin ose të drejtat reale në pasurinë në fjalë.</p> <p>4. Derisa të dëshmohet ndryshe, çdo send i luajtshëm dhe parat që gjenden te personi që është nën shqyrtim, në banesën e tij/saj ose në lokalet tjera, mjetet e transportit, kutitë e forta ose kasafortat, qofshin ato në pronësi apo me qira, do të konsiderohen gjithashtu sende të luajtshme dhe para të gatshme që i përkasin personit që është nën shqyrtim.</p>	<p>2. Any transaction carried out on illegally acquired assets shall have no effect concerning the State and any such transaction shall be confiscated when the transactions concerned are encumbrance transactions with third parties if the parties concerned knew or could have assumed that the assets had been purchased illegally or if the parties concerned had purchased the assets with the intent to conceal their illegal source or real rights related to them.</p> <p>3. Confiscation shall also apply to any asset transferred to a third party on behalf of the person under review to avoid confiscation of the assets concerned or conceal the source or the real rights on the assets concerned.</p> <p>4. Unless proven otherwise, any movable assets and cash held by the person under review, in his/her apartment or other premises, means of transportation, safe boxes or safes, whether owned or rented, shall also be considered as movables and cash belonging to the person under review.</p>	<p>2. Svaka transakcija izvršena na neopravdano stečenoj imovini neće imati dejstvo u odnosu na državu i svaka takva transakcija biće oduzeta, kada se radi o transakciji sa teretom na treća lica, ako su dotične strane znale ili su mogle pretpostaviti da je imovina nezakonito kupljena ili ako su dotične strane kupile imovinu s ciljem da prikriju svoj neopravdan izvor ili stvarna prava vezana sa njom.</p> <p>3.Oduzimanje se takođe sprovodi nad svakom imovinom koja je prenetu trećem licu za račun lica koje je pod proverom, kako bi se izbeglo oduzimanje navedene imovine ili kako bi se prikriji izvori ili stvarna prava na navedenoj imovini.</p> <p>4. Dok se ne dokaže suprotno, svaka pokretna imovina i novac pronađen kod lica koje je pod proverom u njegovom stanu ili drugim prostorijama, prevoznim sredstvima, sanducima ili sefovima, bilo da su u vlasništvu ili pod zakup, takođe se smatraju pokretnom imovinom i gotovina koji pripadaju licu koje je predmet provere.</p>
--	--	---

<p align="center"><b>Neni 44</b> <b>Përmbajtja e aktgjykimit</b></p>	<p align="center"><b>Article 44</b> <b>Content of the judgment</b></p>	<p align="center"><b>Član 44</b> <b>Sadržina presude</b></p>
<p>1. Aktgjykimi me shkrim duhet të përpilohet në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e përfundimit të seancës së shqyrtimit. Kur ekzistojnë shkaqe objektive, të tilla si vëllimi i materialit të lëndës, aktgjykimi duhet të përpilohet në afat prej më së largu gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e përfundimit të seancës kryesore të shqyrtimit. Aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet të jetë në përputhje me aktgjykimin burimor.</p> <p>2. Aktgjykimi përfshinë hyrjen, dispozitivin dhe arsyetimin, me përmbajtjet përkatëse si vijon:</p> <p>2.1.Hyrja e aktgjykimit përmban: shënimin se aktgjykimi merret në emër të popullit, emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e kryetarit dhe të anëtarëve të trupit gjykues dhe të procesmbajtësit, emrin dhe mbiemrin e përfaqësuesit të Byrosë, emrin dhe mbiemrin e palës pasuria e te cilit i nënshtrohet konfiskimit, ditën e mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, nëse seanca ka qenë e hapur apo është mbyllur pjesërisht, emrin dhe mbiemrin e mbrojtësit te palës të pranishëm në seancën e shqyrtimit kryesor, emrin dhe mbiemrin e</p>	<p>1. The written judgment must be drafted within thirty (30) days from the day of the conclusion of the main hearing. When there are objective reasons, such as the volume of the case files, the judgment must be drafted within a maximum of sixty (60) days from the day of the conclusion of the main hearing. The written judgment must be in accordance with the original judgment.</p> <p>2.The judgment shall include the introductory part, the enacting clause and the reasoning, with the relevant contents as follows:</p> <p>2.1. the introductory part of the judgment shall contain the note that the judgment is taken in the name of the people, the name of the court, the name and surname of the presiding judge and the trial panel members and the court recording clerk, the name and surname of the Bureau representative, the name and surname of the party whose assets are subject to confiscation, the day of the main hearing, if the hearing was open or partially closed, the name and surname of the defense counsel for the party present at</p>	<p>1. Pisana presuda mora se sastaviti u roku od trideset (30) dana od dana završetka glavne rasprave. Kada postoje objektivni razlozi, kao što je obimnost predmetnih spisa, presuda mora se sastaviti najkasnije u roku od šezdeset (60) dana od dana završetka glavne rasprave. Pisano izrađena presuda mora biti u skladu sa izvornom presudom.</p> <p>2. Presuda sadrži uvod, izreku i obrazloženje, sledeće relevantne sadržine:</p> <p>2.1. uvod presude sadrži: naznaku da se presuda izriče u ime naroda, naziv suda, ime i prezime predsednika i članova sudskog veća i zapisničara, ime i prezime predstavnika Biroa, ime i prezime stranke čija je imovina predmet oduzimanja, dan održavanja glavne rasprave, da li je rasprava bila otvorena ili delimično zatvorena za javnost, ime i prezime branioca stranke prisutne na glavnoj raspravi, ime i prezime trećeg lica i njegovog branioca prisutnih na glavnoj</p>

<p>personit të tretë dhe mbrojtësit të tij të pranishëm në seancën e shqyrtimit kryesor, datën e përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor dhe datën e përpilimit të aktgjykimit.</p> <p>2.2. Dispozitivi i aktgjykimit përmban: vendimin që miraton propozimin për konfiskim, duke përfshirë numrin dhe datën e propozimit, konstatimin se pasuria është e pajustificueshme dhe urdhrin që ajo pasuri konfiskohet, se ajo pasuri do i kalojë në pronësi apo disponim Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe se për pasurinë që mbahen regjistra, Qeveria e Kosovës do të regjistrohet si pronare. Në dispozitiv bëhet përshkrimi i saktë i të dhënave identifikuese të çdo pasurie që konfiskohet. Kur kërkesa refuzohet në dispozitiv përfshihet vendimi që kërkesa për konfiskim refuzohet si e pabazuar, duke përshkruar numrin dhe datën e propozimit dhe të dhënat që identifikojnë çdo pasuri që është propozuar për konfiskim. Kur janë caktuar masa të sigurimit apo masa të përkohshme për pasurinë, në dispozitiv konstatohet se ato masa mbesin në fuqi deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.</p>	<p>the main hearing, the name and surname of the third person and his/her defense counsel present at the main hearing, the date of conclusion of the main hearing and the date of drafting the judgment.</p> <p>2.2. the enacting clause of the judgment shall contain: the decision approving the proposal for confiscation, including the number and date of the proposal, the finding that the assets are unjustifiable and the order that such assets will be confiscated, that the assets will be transferred to the ownership or disposal of the Government of the Republic of Kosovo and that registers are maintained for assets, and Kosovo Government will be registered as the owner. The enacting clause shall make the exact description of the identification data of each asset that is confiscated. When the request is rejected, the enacting clause shall include the decision that the request for confiscation is rejected as ungrounded, describing the number and date of the proposal and the data identifying each asset that has been proposed for confiscation. When security measures or interim measures have been imposed on the assets, the enacting clause shall ascertain that such measures remain in force until the judgment becomes final.</p>	<p>raspravi, dan zaključenja glavne rasprave i dan sastavljanja presude;</p> <p>2.2. izreka presude sadrži: odluku kojom se usvaja predlog za oduzimanje, uključujući broj i datum predloga, konstataciju da je imovina neopravdana i naredbu da se ta imovina oduzima, da se ta imovina prenosi u svojini ili raspolaganje Vlade Republike Kosovo, te i da za imovinu za koju se vode registri, Vlada Kosova upisuje kao vlasnik. U izreci daje se tačan opis identifikacionih podataka svake imovine koja se oduzima. Ako se zahtev odbije, u izreci se navodi odluka da se zahtev za oduzimanje odbija kao neosnovan, uključujući broj i datum predloga i podatke koji identifikuju svaku imovinu koja je predložena za oduzimanje. Ako su za imovinu određene mere obezbeđenja ili privremene mere, u izreci se konstatuje da te mere ostaju na snazi do pravnosnažnosti presude;</p>
---	--	---

<p>2.3. Në arsyetimin e aktgjykimit, gjykata paraqet arsyetimin për çdo pikë të aktgjykimit. Gjkata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara dhe mbi cilat prova vërtetohen faktet e tilla, si dhe cilat prova nuk vërtetojnë faktet e tilla që palët kanë pretenduar se vërtetohen. Aktgjykimi përmban arsyetimin për konfiskimin e secilës pasuri për të cilën urdhërohet konfiskimi dhe arsyetimin për secilën pasuri për të cilën nuk urdhërohet konfiskimi.</p> <p>3. Aktgjykimi përmban këshillën juridike për të drejtën e ankesës.</p> <p>4. Aktgjykimin e nënshkruajnë gjyqtari dhe procesmbajtësi. Aktgjykimi nënshkruhet vetëm në një (1) kopje që mbetet në shkresat e lëndës së gjykatës, ndërsa kopjet tjera të aktgjykimit konstatohen me vulën e saktësisë së gjykatës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 45</b> <b>Dërgimi i aktgjykimit me shkrim palëve</b></p> <p>1. Gjkata sapo ta përpilojë aktgjykimin me shkrim, ua dërgon secilës palë nga një kopje</p>	<p>2.3. in the reasoning of the judgment, the court shall give the reasoning for each point of the judgment. The court shall clearly and fully state which facts and for what reasons such facts are considered to be established or unproven and on what evidence such facts are established, as well as which evidence fails to prove such facts that the parties have claimed to be established. The judgment shall contain the reasoning for the confiscation of each asset for which the confiscation is ordered and the reasoning for each asset for which the confiscation is not ordered.</p> <p>3. The judgment shall contain the legal remedy on the right to appeal.</p> <p>4. The judgment is signed by the judge and the recording clerk. The judgment is signed only in one (1) copy that remains in the case files of the court, while other copies of the judgment are ascertained with the seal of accuracy of the court.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 45</b> <b>Serving the written judgment on the parties</b></p> <p>1. Once the court has drafted the written judgment, it shall serve a copy of the judgment on each party. A copy of the</p>	<p>2.3. u obrazloženju presude sud iznosi obrazloženje za svaku tačku presude. Sud jasno i potpuno iznosi koje činjenice i iz kojih razloga smatra dokazanim ili nedokazanim, kojim dokazima se te činjenice dokazuju, kao i kojim dokazima se ne dokazuju činjenice koje su stranke tvrdile da su dokazane. Presuda sadrži obrazloženje za oduzimanje svake imovine za koju je naloženo oduzimanje i obrazloženje za svaku imovinu za koju nije naloženo oduzimanje.</p> <p>3. Presuda sadrži pouku o pravnom leku o pravu na žalbu.</p> <p>4. Presudu potpisuju sudija i zapisničar. Presuda se potpisuje samo u jednom (1) primerku koji ostaje u spisima predmeta suda, dok se ostali primerci presude overavaju pečatom tačnosti suda.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 45</b> <b>Dostavljanje pisane presude strankama</b></p> <p>1. Čim sud pisano izradi presudu, svakoj stranci dostavlja po jedan primerak presude.</p>
--	--	---

<p>të aktgjykimit. Kopja e aktgjykimit për palët dërgohet me vulën e saktësisë së gjykatës.</p> <p>2. Gjykata aktgjykimin me shkrim ua dërgon te gjitha institucioneve që mbajnë regjistra të pasurisë si dhe institucioneve që zbatojnë masat e sigurisë apo masat e përkohshme ndaj pasurisë.</p> <p><b>KAPITULLI IX PROCEDURA SIPAS ANKESËS</b></p> <p><b>Neni 46 Ankesa kundër aktgjykimit</b></p> <p>1. Kundër aktgjykimit, palët kanë të drejtë në ankesë në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Mbi ankesën kundër aktgjykimit vendosë gjykata e shkallës së dytë.</p> <p>2. Ankesa i dorëzohet gjykatës së shkallës së parë për Gjykatën e Apelit. Gjykata e shkallës së parë kur pranon ankesën, atë ia dërgon palës kundërshtare, e cila mund të parashtojë përgjigje në ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh. Përgjigja në ankesë duhet të përmbajë të dhëna që i referohen pretendimeve të ankesës.</p> <p>3. Nëse gjykata e shkallës së parë pranon përgjigjen në ankesë, ajo ia përcjell ankesën</p>	<p>judgment for the parties shall be served with the court authenticity seal.</p> <p>2. The court shall serve the written judgment on all institutions that keep asset registers, as well as institutions that implement security measures or interim measures on the assets.</p> <p><b>CHAPTER IX APPELLATE PROCEEDINGS</b></p> <p><b>Article 46 Appeal against the judgment</b></p> <p>1. Against the judgment, the parties have the right to appeal within thirty (30) days. The appeal against the judgment shall be ruled by the second instance court.</p> <p>2. The appeal shall be submitted to the first instance court for the Court of Appeals. The first instance court shall, when receiving the appeal, serve it on the opposing party, which can file a response to the appeal within fifteen (15) days. The response to the appeal must contain information that refers to the appellant's claims.</p> <p>3. If the first instance court receives the response to the appeal, it shall forward the</p>	<p>Primerak presude šalje se strankama sa pečatom tačnosti suda.</p> <p>2. Sud dostavlja pisanu presudu svim institucijama koje vode imovinske registre imovine, kao i institucijama koje sprovode mere obezbeđenja ili privremene mere na imovini.</p> <p><b>POGLAVLJE IX. POSTUPAK PO ŽALBI</b></p> <p><b>Član 46 Žalba protiv presude</b></p> <p>1. Stranke imaju pravo da izjave žalbu protiv presude u roku od trideset (30) dana. O žalbi protiv presude odlučuje drugostepeni sud.</p> <p>2. Žalba se podnosi prvostepenom sudu za Apelacioni sud. Po prijemu žalbe prvostepeni sud istu dostavlja protivnoj strani koja može u roku od petnaest (15) dana podneti odgovor na žalbu. Odgovor na žalbu mora sadržati podatke koji se odnose na žalbene navode.</p> <p>3. Ako prvostepeni sud primi odgovor na žalbu, žalbu sa svim spisima predmeta</p>
--	--	---

